



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës: Vazhdimi i diskutimit për shqyrtimin nen për nen të Aneksit të Projektit Kushtetues

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Jorida Tabaku, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Spartak Braho, Eduard Halimi

Të ftuar:

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri
Jon Smibert - Përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Besoj se jam në rregull me orën që të them mirëmbërëma në këtë pasdite, kështu që mund të fillojmë, meqenëse kuorumi është bërë.

Sot në rendin e ditës kemi pjesën e fundit të projektit kushtetues, aneksin për vlerësimin e kalendarit për kualifikimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Është një pjesë, e cila në vlerësimin tim, ndoshta mund të ketë qenë nga pjesët më të vështira të këtij projekti, për arsye të kuptueshme, edhe për faktin që është dashur të bëhet një punë e madhe për të parë të gjitha përvojat e mundshme që kanë qenë në këtë fushë, për të parë qasjen e zgjidhjeve të dhëna me standardet ndërkombëtare gjithashtu, si dhe pa dyshim ka ngrënë një pjesë të mirë të arsyetimit të dy opinioneve të dhëna nga Komisioni i Venecias, i cili në vlerësimin tim, është shterues lidhur me përmbajtjen e aneksit.

Është gjë pozitive fakti që të gjithë në rrafshin politik kanë mbështetur në mënyrë unanime nevojën e vetingut ose të asaj që quhet vlerësimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve. Të gjithë, pavarësisht forcave politike që kemi përfaqësuar, kemi mbajtur mendimin e përbashkët që është një gjë e domosdoshme në stadin dhe nivelin me problematikat që ka sot sistemi dhe, po gjithashtu ky ka qenë edhe një qëndrim që është mbajtur edhe nga vetë institucionet e sistemit, aktorët dhe faktorët e sistemit, ka qenë dominuese edhe në tryezat publike që janë organizuar për projektin kushtetues dhe kjo është diçka shumë pozitive. Kjo na e bën më të lehtë barrën për shkak se duke mos pasur pozicione të dallueshme, besoj se fokusohemi te çështjet që kanë të bëjnë me karakterin teknik të zgjidhjeve, apo me nevojën që ka për ta përmirësuar nga pikëpamja e harmonizimit të tekstit brenda vetes dhe me pjesën tjetër të projektit kushtetues.

Gjithsesi, mbeten për t'u dëgjuar qëndrimet që kanë kolegët sot. Ky ishte thjesht qëndrimi dhe pozicioni im personal.

Zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Po, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj - Duhet të biem dakord, për arsyet që unë përmenda dhe për të cilat do të doja mendimin tuaj, të cilat mund të jenë të drejta ose jo plotësisht, ndoshta mund të kemi ndryshime në lidhje me vlerësimin që unë thashë. Ndoshta do të ishte mirë që ju të ndanit të

njëtin mendim me mua për sa më lart, mbi të gjitha që të japim një vlerësim të përgjithshëm edhe për arsye kohe, në qoftë se ju nuk keni detaje, sesa t'i marrim germë për germë.

Gjithsesi, këtë e vendosni ju.

Oerd Bylykbashi – Në parim jam dakord, zoti kryetar. Gjithsesi, ne si përfaqësues të opozitës kemi, gjithashtu, propozimet tona konkrete, por do të bëjmë vlerësimin në parim, pra duke mos hyrë nën për nën, sepse besoj se ato janë të lidhura në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën, e për rrjedhojë shkojnë së bashku.

(Diskutime pa mikrofon.)

Jo, nuk kam, por do të bëj një vlerësim të parë, të përgjithshëm në parim të kësaj çështjeje. Pra, partitë e opozitës, si Partia Demokratike, ashtu dhe Partia Republikane në këtë komision e kanë shprehur vazhdimisht dakordësinë e plotë me procesin e vetingut, një proces, i cili do t'i rikthejë besimin sistemit të drejtësisë ose besimin te publiku, sistemit të drejtësisë. Sigurisht që e gjithë kjo që ka ndodhur qoftë edhe retorika e përdorur deri më sot, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka përkeqësuar edhe më tej një gjë që është vërtet në pikë të ulët, pra një perceptim negativ mbi sistemin e drejtësisë, kështu që është detyra jonë ta kemi këtë parasysh, po aq sa Komisioni i Venecias shprehet se një sistem i komplikuar si ky që është paraqitur në draft, me vështirësinë e tij, me rëndesën e tij, me komplikimin e vendimmarrjes dhe eventualisht kapjen e tij dhe bllokimin kur të vijë momenti, konfliktin që do të shkaktojnë këto shumë institucione kundrejt njëra-tjetrës, nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të ulë besimin e sistemit qoftë nga jashtë, qoftë tek ata që do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë apo Gjykatës së Apelit, duke parë se si sistemi në vetvete nuk funksionon.

E thënë kjo, na duhet patjetër të kemi një proces vetingu rigoroz, i cili do të çojë në një pastrim të sistemit të drejtësisë nga gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar dhe të paaftë. Kështu që edhe ne në këtë aspekt, përveç kritikës dhe aspekteve të mendimit ndryshe, kemi propozimet tona konkrete. Një çështje e ngritur me forcë gjatë gjithë kësaj periudhe nga Partia Demokratike, ka qenë fakti që sistemi duhej të ishte më i thjeshtë dhe në propozimin tonë sistemi thjeshtohet. Pra, sistemi thjeshtohet, sepse në sistemin tonë nuk parashikohet që të jetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Pavarur i Kualifikimit si dy trupa, të cilët do të përzgjidhen ndërmjet shumë kandidaturave, për shumë pozicione, për të funksionuar me një funksion *ad-hoc* të kufizuar në kohë, por për fat të keq me një afat të gjatë. Pra, do të kishim një dualitet midis dy sistemesh, atij të përhershëm dhe një të sistemi të ngritur për një periudhë dhe për një funksion

specifik. Ne jemi të mendimit se sistemi do të jetë në gjendje të bëjë vetingun duke nisur nga tani e tutje dhe çka ndodhur në të shkuarën, e për rrjedhojë të jetë funksional dhe integral si sistem.

Ne gjykojmë se Shqipëria nuk ka mjaftueshëm, pavarësisht se u është thënë ekspertëve të Venecias këtu, burime njerëzore për funksione kaq të larta. Ne pa këto të dyja, të cilat do të thithin shumë kandidatura për të arritur në shumë funksionare, do të na duhet një numër i madh kandidaturash për funksionet në institucionet permanente kushtetuese të sistemit të drejtësisë, e për rrjedhojë duhet ta shfrytëzojmë me efikasitet këtë.

Një gjë që duhet të jetë shumë e qartë është se një sistem shumë i rënduar me institucione nuk bën gjë tjetër veçse përkeqëson çështjen politike të vendimmarrjes, për zgjedhjen e funksionarëve, pra çështja me 3/5-at, siç sugjerohet këtu, bëhet akoma më kritike për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve që do të zgjidhen me 3/5-at. Sigurisht që mbeten probleme dhe nuk janë reflektuar siç duhet shqetësimet që ka Komisioni i Venecias në lidhje me nivelin dhe proporcionalitetin e kufizimit të të drejtave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve që sot janë në sistem, e për rrjedhojë neve do të na duhet të jemi të kujdesshëm qoftë për sa i përket kufizimit, qoftë për sa i përket të drejtës së tyre për t'u ankuar në atë që është një gjykatë e vërtetë dhe jo diçka i ngjan një gjykate. Kjo gjë që propozohet këtu nuk përputhet me këtë kërkesë të Komisionit të Venecias.

Një moment shumë delikat dhe serioz, që vë në pikëpyetje procesin, është, gjithashtu, përfshirja e instrumenteve të jashtme, të cilat do të kenë rol në procesin e vetingut, siç propozohet. Avokati i Popullit është një funksion, i cili në vetvete kështu siç është, nuk ka kompetenca ekzekutive dhe në këtë e dimë shumë mirë. Madje në të shkuarën ka refuzuar të ushtrojë edhe funksione që ligji i tij ia jepte në mënyrë specifike. Pra, për ta futur Avokatin e Popullit këtu të mos harrojmë një gjë, ai është përzgjedhur në një mënyrë, e cila vetëm besim nuk i jep atij institucioni, një përzgjedhje haptazi politike me platforma të parashtruara në selinë e një partie politike dhe jo përpara një komisioni parlamentar shqiptar. Për rrjedhojë do të ishte naive të mendohet se Avokati i Popullit do të mund të luante një rol, por ajo që është më shqetësuese, është përfshirja në procesin e vetingut e institucioneve si ILKDP-ja apo të dhënat që do të merren në lidhje me një të kaluar jo të përshtatshme në raport me individë problematikë, qoftë edhe me rekorde kriminale që do të merren nga Policia e Shtetit. Të dyja këto japin mundësinë që qeveria të ketë akses dhe të dominojë procesin. Përveç asaj që ka arritur nëpërmjet vendimmarrjes me shumicë të cilësuar në parlament prej 3/5, të ketë mundësinë që të jetë ajo që

të kondicionojë qartë dhe haptazi mënyrën sesi do të bëhet veting dhe për rrjedhojë të jetë selektiv.

E dimë shumë mirë që ILDKP-ja është një organ shumë i politizuar dhe për fat të keq është kjo maxhorancë që me një votim antikushtetues ka bërë të mundur që kjo të ndodhë. Nga ana tjetër është një organ, i cili nuk ka nivelin kushtetues e për rrjedhojë për këtë arsye ne në propozimet tona, të cilat i kemi diskutuar më herët, kemi propozuar që të jetë një organ kushtetues si Inspektori i Lartë i Drejtësisë të kryejë funksionet e saj për sistemin e drejtësisë.

Nga ana tjetër nuk mund të bazohemi tek ajo që bën në mënyrë selektive qeveria, nëpërmjet policisë për sa i përket të themi kontrollit të të dhënave, sepse kjo sigurisht të çon në një pikëpyetje të madhe mbi funksionimin e kësaj procedure kaq themelore për besimin e publikut ndaj sistemit të drejtësisë.

Pra, ka shumë çështje që lidhen me arkitekturën e sistemit. Ne e kërkojmë të thjeshtuar, ndërsa ju e kërkonit të komplikuar; ne e kërkojmë të thjeshtuar që të funksionojë, ndërsa ju e kërkonit të komplikuar, sepse në gjykimin tonë kjo ju siguron kapjen.

Ajo që e përkeqëson më shumë është çështja tjetër politike, që vendimmarrja me shumicë të cilësuar, e cila është e pazgjidhur dhe ajo që propozohet këtu e përkeqëson. Ne mendojmë se këto funksione duhet të transferohen për pjesët e poshtme nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të bëhen nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, pra atë punë që ata do të bëjnë rregullisht, ndërkohë që monitorimi ndërkombëtar dhe vetingu për funksionet më të larta KLGJ dhe KLP, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese të bëhet nga një komponent i fortë ndërkombëtar. Sigurisht, më pas do të shkojmë te çështjet e tjera që kanë të bëjnë, siç edhe e thashë me mospërfshirjen në proces të institucioneve, të cilat janë qartazi të kapura, të kontrolluara apo janë nën varësinë e drejtpërdrejtë, organike dhe funksionale të qeverisë. Kështu që unë besoj se në propozimet tona do të ketë një rikonceptim krejt tjetër, por për të arritur të njëjtin qëllim me të njëjtin rigorozitet, në mos më tepër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Me aq sa unë kuptova, ju jeni pro, por me rezerva të forta për mënyrën se si është realizuar procesi.

Oerd Bylykbashi – Jemi pro procesit të vetingut, sepse edhe ne kemi një aneks në mënyrë të detajuar. Në 10 nene besoj që bën të njëjtin gjë vetingun, por në mënyrë krejt tjetër,

duke transferuar funksionet për gjyqtarët e të gjitha niveleve dhe prokurorët te KLGJ-ja dhe te KLP-ja.

Fatmir Xhafaj – KLD-ja e sotme.

Oerd Bylykbashi – KLGJ-në, KLP-në, ILD-në dhe ILD-në që do të kontrollojë këto të dyja më pas dhe do të merret me disiplinimin. Gjykatën Kushtetuese ta ketë komponenti ndërkombëtar, që do të bëjë vetingun e tyre dhe këta do të bëjnë atë punë që në fakt do ta bëjnë për gjyqtarët dhe prokurorët nga tani e tutje, ata që do të merren në punë nga tani e tutje, ndërsa ne ia japim edhe për atë që ka ndodhur në të shkuarën, pasi i kemi pastruar. Në qoftë se ne nuk kemi besim edhe përgjatë një periudhe të konsiderueshme monitorimi ndërkombëtar për KLGJ-në dhe KLP-në. Pra, në qoftë se ne nuk kemi besim sot nuk kemi për ta pasur as nesër.

Pra, një gjë ta bëjmë në mënyrë unike, si duhet, përndryshe e gjithë kjo është skemë që do të çojë pa diskutim më pas edhe në nevojën se sa nga këta anëtarë të KPPK-së apo të kolegjit do të jenë të një krahu apo të një krahu tjetër në përzgjedhjen me shumicë të cilësuar në parlament. Unë besoj se kjo vetëm pavarësi të procesit nuk krijon, por krijon edhe më shumë influencë politike.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka komente të tjera?

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Me çfarë unë po kuptoj nga deklarata e zotit Oerd, ne kemi të bëjmë më tepër me një deklaratë të përgjithshme politike, qoftë për procesin, qoftë për pozicionin e Partisë Demokratike për sa i përket çështjes së reformës në drejtësi dhe ndryshimeve kushtetuese. Meqenëse bëhet fjalë për një deklaratë politike, më lejoni t’ju citoj një deklaratë tuajën, që paraardhësit tuaj e kanë depozituar në datën 09.05.2016. Po lexoj vetëm një paragraf të kësaj deklarate, është paragrafi i fundit në faqen 2 “Drafti i 4 majit 2016”, citoj, “është drafti mbi të cilin ne kemi filluar, kemi vazhduar dhe po vazhdojmë të diskutojmë ndryshimet kushtetuese të përgatitura nga ekspertët ndërkombëtarë dhe ata shqiptar”. Në të citohet: “Drafti i 4 majit i vitit 2016 vjen si një produkt i këtyre përpjekjeve të ekspertëve të opozitës, të cilët me përkushtim, durim, profesionalizëm dhe racionalitet arritën të bindin Komisionin e Venecias dhe ekspertët ndërkombëtarë, për të ndryshuar pozitivisht draftin dhe për ta sjellë atë në pjesën dërmuese pran standardeve euroatlantike, duke çmontuar qartësisht skemën e kapjes politike të sistemit, për të garantuar pavarësinë, llogaridhënien dhe luftën reale ndaj korrupsionit”.

Tani, ju mund të keni mënyra të ndryshme dhe mendoj se çdo jurist ka një opinion të vetin për çështje juridike dhe është i lirë që ta ketë këtë, por ne nuk mund të vijmë dhe të vazhdojmë diskutimet sa herë ju vetë ndryshoni opinionet tuaja. Jua thanë edhe herën e kaluar ekspertët ndërkombëtarë që, për shembull për Këshillin e Lartë të Emërimeve, opinionin e Partisë Demokratike ka përballë opinionin e vetë Partisë Demokratike. Ndryshimi i opinionëve tuaja në vazhdim thjeshtësisht e ka trajtuar problemin në një mënyrë shumë simpliste. Ne kemi bërë diskutimin nen për nen dhe propozimet e Partisë Socialiste kanë qenë shumë të qarta, për çdo nen ne kemi bërë propozimet tona nuk kemi bërë diskutime të natyrave politike, ne i kemi qëndruar asaj që kemi thënë që në fillim fare: do të shkojmë sipas vërejtjeve të Komisionit të Venecias dhe në fund, në qoftë se do të kemi keqkuptime apo keqinterpretime nga të dyja palët, pra si nga pala jonë, nuk e kemi përjashtuar palën tonë që mund të bëjmë keqinterpretime, ashtu edhe nga pala juaj në marrëdhënie me ne, do të jetë ekspertiza ndërkombëtare ajo që do të japë një gjykim fundor si pjesë e rëndësishme e konsensusit që është i nevojshëm nga të dy palët.

Surpriza bazë mbi të cilën ne jemi duke e bërë dhe po e trajtojmë si një çështje të rëndësishme politike, është që ne kohë më parë e mbyllëm diskutimin politik dhe juridik për sa i përket infrastrukturës dhe arkitekturës të sistemit që do të jetë garant i reformës së drejtësisë. Të dyja palët ramë dakord për sa i përket kësaj strukture, kësaj infrastrukture dhe për më tepër ne mund të hapim procesverbalet, të cilat publikohen rregullisht dhe zbardhen po ashtu, janë pjesë e diskutimeve tona të dyanshme për këtë çështje.

Në qoftë se ju në fund fare vini dhe na thoni se opinionet tuaja kanë ndryshuar nga ato të mëparshmet, ky nuk është një problem yni, por është juaji. Gjithashtu, dëshiroj të kujtoj se këto ndryshime opinionesh nuk kanë ardhur në momentin që çështja po diskutohet në parim, kjo ka ardhur pikërisht tani që ne po e mbyllim këtë çështje. Ne nuk mund ta vazhdojmë pambarimisht një histori, e cila nuk kuptohet se ku fillon si çështje juridike dhe ku mbaron si çështje politike; nuk dihet se ku fillon si çështje serioze dhe ku mbaron si çështje qesharake. Prandaj do t'ju lutesha që ne t'ia ruajmë seriozitetin kësaj tavoline të nderuar, të vazhdojmë diskutimin nen për nen në kapitullin e fundit për të cilin kemi rënë dakord edhe në mbledhjen e fundit, dhe në fund fare secili është i lirë në vendimmarrjen e tij fundore.

Një gjë është e sigurt: sido që të ndodhë, çfarëdo që të diskutojmë, këto ndryshime kushtetuese nuk mund të kalojnë me votat tona, do të duhen edhe votat tuaja; një gjë po kaq është e sigurt që në çfarëdolloj matematike që të merret me koalicion apo pa koalicion edhe për

vetë mënyrën se si reforma e drejtësisë do të jetë e zgjatur në kohë, ky sistem që është ndërtuar është ndërtuar i tillë që të mos kapet nga asnjë parti politike dhe në qoftë se do të bëja ironi ky sistem i shkruar në letër nga ekspertiza ndërkombëtare e Bashkimit European dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ka një të metë përballë psikologjisë sonë të vjetër të pasviteve 90-të, ky nuk mund të kapet dot nga ne, ky nuk mund të prodhojë gjykatës me vendim partie, gjykatës që mund të merren në telefon. Ka vetëm një mundësi që gjykatësit të vendosin për gjykatësit, prokurorët të vendosin për prokurorët dhe për gjithsecilin të vendosë kurikulumi, CV-ja, aftësia, eksperiencia në punë, vendimmarrja apo mënyra se si gjykatësit kanë respektuar standardizimet që kanë bërë gjykatat e niveleve më të larta.

Në thelb, ajo që dëshiroj të them pa u zgjatur më shumë dhe besoj se flas edhe në emër të gjithë kolegëve, është se ne do të qëndrojmë jo thjesht për formalizëm, as thjesht për një logjikë se kështu kanë thënë ndërkombëtarët. Është një histori e vjetër kjo dhe dikujt që na kundërshton në emër të sovranitetit apo të ruajtjes së personalitetit të vendimmarrjes të politikës shqiptare dëshiroj t'i them fare shkurt: ne do të shkojmë dhe do të bëhemi pjesëtarë të Bashkimit European, do të vendosin ata të na pranojnë dhe pastaj do të jemi ne që do të hyjmë në atë shtëpi. Populli shqiptar e ka marrë vendimin për të shkuar në Bashkimin European, ne thjesht duhet të zbatojmë kërkesat e të zotërve të shtëpisë për të plotësuar kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria, sistemi i drejtësisë dhe shteti shqiptar për t'u bërë pjesë e Bashkimit European.

Ju ftoj t'i përgjigjemi kësaj kërkesë, sepse kjo kërkesë është e shkruar e zeza mbi të bardhë në dokumentin, të cilin ju me shumë elokuencë, e ripërsëris në dokumentin që mban titullin “Konsiderata të përgjithshme dhe amendamentet kushtetuese të datës 14.05.2016”, e vlerësoni si një produkt të përpjekjeve të ekspertëve të opozitës që me përkushtim, me durim, me profesionalizëm dhe racionalitet arritën të bindnin Komisionin e Venecias dhe ekspertët ndërkombëtarë për të ndryshuar pozitivisht draftin. Ja ku e keni draftin, ejani ta votojmë.

Zoti kryetar i komisionit, propozoj që të procedojmë sipas asaj që kërkon Rregullorja normale e funksionimit të këtij komisioni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju u shprehët politikisht, por do t'i lind e drejta edhe kolegut Majko, sepse kështu i bie.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ai nuk e kishte me ju personalisht, por me fjalën tuaj dhe shprehu pozicionin e vet.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë fola për draftin dhe bëra komente juridike në lidhje me të.

Fatmir Xhafaj – Jo, ishin politike.

Oerd Bylykbashi – Duke qenë se kolegu Majko bëri ndërhyrje politike dhe vetëm politike, sigurisht që unë nuk kam mundësinë që ta mas zotin Majko, përveçse me thirrjen ndaj komisioni për të votuar pa e lexuar asnjëherë draftin dhe e vetmja gjë që matet është me këtë. Besoj që ishte pikërisht leximi pas kësaj deklarate që e shtyu zotin Majko disa herë të propozonte një numër të konsiderueshëm nenesh të ndryshme, qoftë edhe thelbësisht të ndryshme nga propozimi, për shembull rasti i KRK-së nga propozimi që bëjnë ekspertët ndërkombëtarë. Pra, edhe zoti Majko u shqetësua, pasi e lexoi dhe i pati idetë ndryshe, kështu që unë nuk di ku ta mas zotin Majko në këtë aspekt.

Për sa u takon leksioneve që të gjithë ne i dëgjuam në lidhje me integrimin europian, unë besoj se shqiptarët kanë së paku që nga viti 2009 që na e kërkojnë këtë, përpara se ju të fillonit historinë me kuti, përpara se të bllokoni 20 ditë bulevardin; përpara se neve të na duhej një marrëveshje bipartizane, më qesharakja ku më është dashur të marr pjesë ndonjëherë, unë dhe të gjithë kolegët e opozitës, të maxhorancës në atë kohë, për të hartuar një marrëveshje shumë të lavdëruar edhe nga Bashkimi Europian. Për të bërë çfarë? Një kalendar të një liste ligjesh me shumicë të cilësuar përfshirë ndryshime në Kodin Rrugor për tahometrën apo tahografin. Kemi qëndruar me javë në pritje që ju të binit dakord edhe për ngjyrën e tahografit vetëm e vetëm se mendonit që kishit kapur një listë me ligje me shumicë të cilësuar dhe do t'i bllokoni. Marrëveshja lapidare e nëntorit të vitit 2011, zoti Majko, e përshëndetur edhe nga zoti Fyle në atë kohë, kishte parasysh vetëm një kalendar ligjesh që ju i kishit bllokuar njërin pas tjetrit. Nëse ju nuk do të na kishit bllokuar në ato diskutime do të ishim bërë vend me negociatë të hapura në vitin 2010 maksimumi në vitin 2011. Besoj se ju keni përgjegjësi për këtë, pasi unë nuk kam qenë në këtë sallë parlamenti në atë kohë, kështu që mos hajdeni t'i tregoni opozitës se cili është vullneti juaj për integrimin europian dhe që nuk e paskan të tjerët.

Për sa i përket aspektin dialektik të këtij procesi, unë nuk e kam studiuar, zoti Majko, dialektikën ose e kam studiuar shumë pak, por besoj se ju e kuptoni që mbi bazën e të gjithë kontributit që kemi dhënë ne deri më sot, dy herë Komisioni i Venecias e ka rrëzuar draftin që keni propozuar ju në mënyrë të njëanshme dhe ekspertët vazhdojnë të bëjnë propozime, por thonë: çështjet politike do t'i zgjidhni ju. Pra, të paktën janë dy çështje politike: sistemi dhe

vendimmarrja, sepse ato janë çështje të cilat ne i propozojmë për zgjidhje për t'i negociuar së bashku. Ju kërkoni të thoni e bëjmë ne? Ne themi se ajo bëhet si kjo, përndryshe gjëja më e mirë që kemi bërë në gjithë këto vite është që të ulemi dhe të merremi vesh për një gjë që funksionon. Sa për kapjen, zoti Majko, po jua garantoj unë që me këtë sistem është ajo që ju ka thënë Komisioni i Venecias në dhjetor: Garanton dhe solidifikon kapjen për tani, për një 10 vjeçar. Kjo është e para.

Së dyti, me këtë sistem ne ju garantojmë që ju kolapson sistemi brenda, përveçse e keni kapur do kolapsojë sistemi i drejtësisë brenda një 10-vjeçari. Pse? Sepse ju keni ndërtuar një sistem ku institucionet vetëm përplasen me njëri-tjetrin, por nuk vë përpara drejtësisë ministrat tuaj të korruptuar dhe ky është një shqetësim i madh. Pra, edhe t'i qëndrojmë kapjes nga jashtë, por edhe të bëjmë një sistem i cili funksionon dhe jep drejtësi, përfshirë atë për ministrat e korruptuar.

Me sa unë mbaj mend, ju keni reflektuar për këtë draft, keni bërë edhe propozimin, ne kemi propozimet tona dhe do të vijmë në një marrëveshje për të, e thatë vetë që do ta bëjmë bashkë, vetëm nuk e bëni dot dhe ne vetëm nuk e bëjmë dot. Pra një sistemi, i cili jo vetëm që konsumon energji pa fund, jo vetëm për personat që duhet t'i çojmë atje, por edhe me gërmërin që do t'i shkaktojnë njëri-tjetrit këto institucione me një rrjet klienteliste dhe korporatiste, ne kemi një gjë më të thjeshtë, është një model evropian i përmirësuar duke hequr klientelizmin dhe korporatizmin që ka KLD-ja e sotme, duke futur një komponent antikorrupsion që nuk është deri më sot. Imunitetin ia kemi hequr, të përmirësojmë sistemin, e kemi forcuar ashtu siç nuk është forcuar ndonjëherë, kemi bërë punë të përbashkët, keni bërë ju, kemi bërë ne, kanë bërë ekspertët, Komisionit i Venecias na ka dhënë guidat. Hajdeni të gjejmë gjuhën e përbashkët deri në fund, nëse kemi ne këtë draft, ndërsa ju keni draftin tjetër hajdeni ta provojmë. Por, jeni në rrugë të gabuar zoti Majko, nuk është kjo detyra që ka ky komision. Ky komision është për të propozuar draftin dhe për të filluar më pas procedurën sipas nenit 177, por ne jemi larg ende prej atyre, por me pak durim do të ecim shpejt.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Unë mendoj se duhej t'ia kishit kursyer këtij komisioni parullat e partive politike, sepse nuk bëhet projekt kushtetuta me parulla, por, gjithsesi nuk dua të merrem fare me analizën e asaj që ju sapo thatë. Është një gjë se sa herë që fillojmë janë të njëjtat fjali.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mirë, por unë jam këtu dhe nuk mund të rri pa ju kthyer përgjigje juve, nuk mund të bëhet me parulla projekti kushtetues. Ju keni gjetur rrugë të gabuar për këtë gjë, sepse të thuash: shiko ky është një draft kështu e një draft ashtu dhe më pas të thuash: shiko ky duhet përmbysur se duhet bërë një tjetër, të dyja nuk rrinë bashkë, por ju...

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord, por të dyja nuk rrinë bashkë. Minimumi, dhe këtë po jua them shumë miqësisht, është hipokrizi ndërkombëtare, këtë emër do t'i vë.

Ju lutem, të hyjmë në diskutim teknik, pastaj kemi kohë.

Vasilika Hysi – Unë nuk do të doja të bëja diskutim politik, por do të doja të jepja një vlerësim të përgjithshëm të aneksit, që e kemi sot për objekt shqyrtimi. Ndërkohë, duke dashur të evidentojë disa nga ato pretendimet që ngriti kolegu dhe që unë i vlerësoj të padrejta. Në fakt, jemi ne që kemi kaq kohë dhe themi që ka nevojë për një reformë në drejtësi dhe që nga një elementet e kësaj reforme janë burimet njerëzore, pra kualifikimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve. Në këtë aneks të Kushtetutës janë përcaktuar disa hapa, të cilat synojnë konkretisht të realizojnë atë skanim ose rivlerësim të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke shmangur dy shqetësime, që janë përmendur gjerësisht në raportet e kolegëve të opozitës, kapjen e institucioneve dhe monitorimin nga ndërkombëtarët, si një nevojë e domosdoshme.

Në fakt, hapi i parë që hidhet në këtë aneks, është nevoja për të kufizuar disa të drejta kushtetuese, përndryshe nuk do të mund të bëjmë verifikimin e tre elementeve të domosdoshëm, që duhet të ketë një gjyqtar dhe prokuror: pasuria, figura, profesionalizmi dhe etika. Ndaj, nëse në nenin A të këtij aneksi parashikohen disa kufizime të të drejtave kushtetuese në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, besoj se kjo tregon më së miri që nuk ka as kapje, as ndërhyrje të politikës, por është e domosdoshme të bëhet. Krijimi i dy komisioneve, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit nga mënyra si zgjidhen, mban atë shqetësim që tha edhe kolegu Bylykbashi, shmangien e politikës dhe kapjen nga institucione të tjera. Nuk besoj se Avokati i Popullit dhe ILDKPI-ja të ndikojnë dhe të kapin misionin e huaj ndërkombëtar që krijohet dhe pasqyrohet në nenin B të këtij aneksi, i cili në vendimmarrje është në shumicë, pra në organizim nga 5 anëtarë, 3 janë të huaj. Nëse ne arrijmë që në këtë reformë të kemi ndikim ose mision monitorues ndërkombëtar, kjo është shkaktuar nga vetë ne, sepse, nëse do të ishim kaq të zotë, mund ta kishim bërë reformën pa qenë nevoja të kishim ndërhyrjen ndërkombëtarëve. Përderisa për 25 vjet nuk arritëm ta bënim dhe nuk kemi besim reciprok te

njëri- tjetri dhe institucionet, atëherë u jepet roli vëzhguesve ndërkombëtarë, të cilët do të mbështesin procesin, do të bashkëpunojnë, do të monitorojnë, njëkohësisht kanë edhe detyra konkrete. Pa dyshim që bashkëpunimi me ta do të jetë sipas ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare dhe të gjithë rregullave të tjera. Unë nuk e kuptoj se ku është kapja apo ndikimi i politikës.

Nga ana tjetër, ju përmendët këtu që në këtë proces nuk ka nevojë të krijohen këto mekanizma, siç është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji, të cilët zgjidhen me një thirrje të hapur, transparente, me kritere të forta dhe që në këtë përzgjedhje përsëri do të ketë ekspertë ndërkombëtarë të BE-së apo të partnerëve, në kuadër të bashkëpunimit euroatlantik. Ju na ktheni te KLGJ-ja, te Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe te inspektori, por po të rikujtojmë se çfarë keni thënë deri sot për këto tre institucione, ju keni qenë kundër në të gjithë diskutimet. Ju keni thënë se mënyra si zgjidhen ata, anëtarët, nuk është zgjidhja që është propozuar në projektin e dakordësuar me Komisionin e Venecias, por ia lini Gjykatës Kushtetuese, kësaj gjykate ekzistuese. Pra, me këtë nuk bëhet reformë. Më falni, që e them, me gjithë respektin që kam për kolegët anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, ne gjithçka e kemi të përqendruar tek anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, duke i vënë tani ata totalisht në konflikt interesi, do të jenë ata që do të zgjidhin të gjitha institucionet. Gjithashtu, unë nuk arrij të kuptoj, dhe sinjerisht ndjehem keq, se çfarë nuk shkon tek tri kriteret që janë vënë në këtë aneks.

Së pari, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, po të shikoni, nuk është vetëm Inspektorati i Lartë i Pasurisë, nuk është vetëm Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Pasurive, që ju ju tremb, por ka një ligj të posaçëm në nenin D ku thuhet se të gjitha këto deklarata i gjykon një komision, i cili ka tre të huaj, tre ndërkombëtarë. Tani, kujt i trembemi? U trembemi dy shqiptarëve apo stafit ndërkombëtar te vlerësimi i pasurisë?

Nga ana tjetër, po në këtë projektligj thuhet se do të ketë disa kritere shtesë lidhur me elementet se cila do të quhet pasuri e ligjshme e të tjera. Unë personalisht nuk shoh ndonjë gjë të keqe. A ka ndonjë gjë të keqe që të kontrollohet dhe të saktësohet se cila është pasuri e ligjshme dhe cila e paligjshme?

Ajo që është risi, është ndryshimi i barrës së provës. Por ndryshimi i barrës së provës shoqërohet me një proces të rregullt ligjor. Këto janë dy elemente që duhen parashikuar në këtë aneks të Kushtetutës, sepse devijojnë nga parimet e përgjithshme dhe kjo bëhet pa dyshim te vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe te vlerësimi i aftësisë profesionale.

Edhe për sa i përket shqetësimit tuaj se ky është proces i kapur dhe e vlerëson politika. Unë nuk shoh në nenet D dhe E asnjë ndërhyrje të politikës të vlerësimi i aftësive profesionale apo i figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, sepse ky lloj vlerësimi, në radhë të parë, vlerëson gjendjen aktuale dhe u jep një shans atyre që kanë nevojë për të rritur, për të freskuar, për të pasuruar njohuritë, duhet t'i nënshtrohen shkollës së Magjistraturës, ose ata të cilët nuk e justifikojnë, për shkak të pasurisë, etikës lidhjes me botën e krimit, të ikin. A jemi ne për këtë pastrim? Besoj se jemi. Ky lloj vlerësimi, që do ta bëjë ky komision dhe ky kolegji, të cilët do të përzgjidhen nëpërmjet një procesi shumë të hapur, transparent me mbikëqyrjen dhe me asistencën e misionit ndërkombëtar, të jetë i kapur nga maxhoranca. Besoj ju doni ta kapni, por nuk e kapni dot me variantet që kanë ardhur.

Gjithashtu, ajo, që do të doja të theksoja është se në aneks ka dy lloje vlerësimesh: vlerësimi i shkallës së parë dhe vlerësim në shkallë të dytë. Pra, deri sot, po të shikoni mënyrën se si funksionon KLD-ja, besoj biem dakord se nuk ka pasur proces të rregullt ligjor as në emërimet, as në transferimet e të tjera. Këto janë dy gjëra të theksuara qartë: vlerësimin e shkallës së parë që e bën një trupë gjykuese, që është komisioni i pavarur i kualifikimit, kemi edhe kolegjin, shqyrtimin në nivelin e apelit, me kritere shumë të qarta dhe pa mohuar Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut.

Pra, nëse ka diçka për të cilën ne duhet të fillonim sot diskutimin, të dashur kolegë, ne duhet ta kishim filluar nga këto elemente, t'i kalonim nën për nën dhe t'i diskutonim këto.

Meqenëse kolegu bëri një akuzë për kolegun Majko dhe tha se kolegu Majko është vetë ai që ka sjellë ndryshime. Jo. Edhe unë kam propozuar ndryshime në këtë komision. Ne jemi një komision i posaçëm i reformës dhe kemi përgjegjësi për atë draft që do t'i çojmë seancës plenare. Por kjo nuk do të thotë që ne të hedhim poshtë 2 vjet punë që kanë bërë shumë ekspertë, profesorë akademikë, ekspertë vendas dhe të huaj, siç tha kolegu. Jo, ne mbi këtë dokument kemi të drejtë të bëjmë pyetje të sqarohemi, sepse dokumenti që prodhohet nga kjo mbledhje, është dokument parlamentar, i cili do të shërbejë sa herë që do të ketë paqartësi në praktikë, për të kuptuar thelbin e debatit se çfarë kemi dashur të themi. Shumë herë ne bëjmë pyetje edhe për të lënë rekorde në procesverbal, për të kuptuar përmbajtjen e këtyre ligjeve, por nga ana tjetër, edhe për të sqaruar veten tonë para se të votojmë. Por, kjo nuk do të thotë se ne jemi kundër. Në rast se ne bëjmë sugjerime, sidomos kolegu Majko ka qenë më aktiv dhe ka bërë riformulime apo

Ulsi, apo Vasili apo unë, këtë e bëjmë që gjuha e Kushtetutës të jetë sa më e qartë, e pastër, pa ekuivok.

Besoj se kjo është detyra jonë në draftimin e këtij ligji, por edhe e juaja bashkë, si anëtarë të komisionit, por kurrsesi ne nuk mund ta kthejmë debatin në pikën zero, pra të fillojmë nga zero, sa herë që hapet seanca.

E fundit, në rast se ne sot kemi diskutime dhe kemi disa nene me dy opsione, çka na jepet e drejta të përzgjedhim, Ekspertët kanë bërë dy variante të neneve, sepse e keni kërkuar ju. I keni paraqitur tri herë: 72 faqe dokumentin e parë, 49 pyetje dokumentin e dytë, 44 faqe tani. Normalisht, ekspertët na kanë sjellë dy variante dhe na kanë lënë mundësinë të zgjedhim. Nëse ne themi se na pëlqen opsioni dy, nuk na pëlqen opsioni i parë, nuk na ka ndërhyrë asnjë ekspert. Ne kemi të drejtë të zgjedhim, duke pasur parasysh harmonizimin e të gjitha neneve të Kushtetutës, por edhe të ligjeve të tjera.

Ndaj, të nderuar kolegë, është mirë t'ia kursejmë njëri-tjetrit këto debate dhe të fillojmë e të rregullojmë një për një këtë aneks, për të cilin biem dakord të gjithë, që rregullon procesin më të rëndësishëm të fillimit të reformës, që është rivlerësimi i të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve. Pa këtë, sado institucionet të ngremë ne, nuk kanë vlerë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Strazimiri, para se të fillojmë nen për nen.

Gent Strazimiri – Besoj se do të jetë ezauruese. Zonja Hysi, ne nuk kemi as më të voglin problem me qëllimet, të cilat ju me aq emocion i paraqitët këtu, qëllime që janë, po ashtu, edhe tonat.

Po ku ndahemi ne? Ne ndahemi, sipas mendimit tim, te fakti se ju keni problem me leximin. Në çfarë kuptimi? Ashtu sikurse donit, pa lexuar, të miratonit një draft, siç tha zoti Majko, ashtu sot po kërkoni, pa lexuar, pa marrë vesh se çfarë propozojmë ne, nen për nen, se ne nuk kemi hyrë ende nen për nen, vetëm ideja që ne kemi një mendim tonin, ju bën të jeni kundër. Jo, kjo nuk mund të jetë mënyra për të arritur te qëllimi. Shumë mirë që ka dy opsione. Po qe se mund të ketë edhe një të tretë, a është problem? Nëse ky opsioni i tretë, që eventualisht ne propozojmë sot, mbase mund të jetë edhe më i mirë se dy të tjerët, mund të jetë shumë afër perfekte, a ia vlen ta lexosh, minimalisht ta dëgjosh? Mbase edhe ai opsion që ne paraqesim, është i frymëzuar nga të njëjtat qëllime fisnike, siç i keni ju, madje qoftë edhe 0,1% e rasteve që

kjo ana këndeje e tavolinës të ketë qëllime krahasimisht fisnike, siç i keni ju për reformën në drejtësi.

Besoj se parimisht ta hedhësh poshtë vetëm faktin për ta dëgjuar apo qoftë edhe teorikisht se ka një variant që mund të jetë ndoshta më i mirë, kjo do të thotë praktikisht jo, jua kam thënë 100 herë, për më tepër kur jeni të ndërgjegjshëm se pa marrë edhe sensibilitet tona, e bëni të porealizueshme këtë reformë. Duke qenë të ndërgjegjshëm që aritmetikisht kemi nevojë të gjithë për njëri-tjetrin, ne po përpiqemi të kontribuojmë, duke nxjerrë disa sensibilitete tonat. Ju thjesht refuzoni t’i lexoni dhe t’i dëgjoni. Kam përshtypjen se kjo pavarësisht retorikës, do t’ju çojë te 9%-shi, jo te 91-shi. 91-shi që e do reformën, kërkon konsensus. Minimalisht dëgjojeni. Keni disa kolegë përballë që sjellin një mendim po aq të kualifikuar, minimalisht, meritojnë të dëgohen. Keni një orë e ca që po thoni pse nuk doni të na dëgjoni dhe pse është veprim armiqësor që të paraqesim dhe ne dy-tre opsionet tona për gjënë, duke qenë se të gjitha opsionet i kemi te drafti që kanë bërë këta ekspertë, që ua ka rrëzuar dy herë Venecia. Kjo nuk është logjike! Kjo ku ju çon te 91%-shi që nuk e do reformën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, faleminderit!

Pasi u zbuluan edhe armiqtë, tani na mbetet të flasim për miqtë.

Neni “A”. “Masa për të fituar besimin e publikut”.

A keni ndonjë mendim? Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Unë kam një vërejtje teknike. Propozoj që paragrafi i pikës 1 të nenit “A” të ndahet në dy paragrafë, paragrafi i parë të mbarojë aty ku thuhet: “sipas nenit 17 të kësaj Kushtetute” dhe pastaj të gjitha subjektet e përmendura në nenin 179/b, paragrafi i parë i Kushtetutës “rivlerësohen, pavarësisht rasteve të transferimeve ose lejeve të përkohshme për shkak të detyrës” të bëhet pikë 2.

Kam dy vlerësime për rregullime fjalësh te paragrafi i parë, por mendoj se këto mund t’i depozitoj dhe të shikohen nga ekspertët. Për pikën 2, që bëhet 3, jam dakord edhe për pikën 3 që bëhet pika 4 jam dakord.

Oerd Bylykbashi – Meqë hymë në diskutimin sipas neneve të veçanta, kam një propozim për nenin 1(ne i emërtojmë me numra).

“Masa për të fituar besimin publikut”:

1. Të gjithë funksionarët, e parashikuar në nenin 179/2 të Kushtetutës i nënshtrohen një procesi të posaçëm rivlerësimi profesional dhe moral bazuar në parimin e: a. ligjshmërisë dhe procesit rregullit ligjor; b. respektimit të të drejtave të lirive themelore të njeriut, c. objektivitetit profesionalizmit dhe efikasitetit; ç, llogaridhënies, integritetit, transparencës; d, rritjes së besimit të publikut te sistemi i drejtësisë; dh, meritokracisë, pavarësisë dhe paanshmërisë; f, konfidencialitetit për rastet e parashikuara me ligj.

2. Rregullat e procesit të posaçëm të rivlerësimit profesional dhe moral, të përcaktuara në këtë pjesë, kanë epërsi ndaj rregullave të përcaktuara në pjesët e tjera të kësaj Kushtetute, deri më datë 31 dhjetor 2022. Në këtë rast, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, duke përfshirë nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës dhe nenet 128, 131, shkronja f, 135, 138,145 paragrafi e parë dhe paragrafi 149 /9, shkronja “b” kufizohen pjesërisht sipas nenit 17 të kësaj Kushtetute, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe në masën që lejojnë zbatimin rregullave të kësaj pjese.

3. Funksionarët e parashikuar në nenin 179 /2 të Kushtetutës, pavarësisht nëse janë transferuar në një detyrë tjetër shtetërore apo janë me leje të përkohshme sipas ligjit, kanë detyrimin dhe të drejtën t'i nënshtrohen procesit të posaçëm të rivlerësimit profesional dhe moral.

4. Procesi i posaçëm i rivlerësimit profesional dhe moral është i përkohshëm dhe ka për qëllim vetëm verifikimin, identifikimin e funksionarëve të përcaktuar në nenin 179/2, që janë të papërshtatshëm për ushtrimin e profesionit të tyre.

5. Pas përfundimit të procesit të rivlerësimit, sipas kësaj pjese, subjektet e parashikuara në nenin 179/2 të kësaj Kushtetute i nënshtrohen regjimit të përhershëm të llogaridhënies sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Fatmir Xhafaj – Më falni, nëse ju nuk i dalloni dot, nuk është përgjegjësia ime.

Po, zonja Hysi

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me këtë nen, unë kam një pyetje dhe një sugjerim. Në radhë të parë, në titull të aneksit është vënë fjala “vlerësim”, ndërsa në vazhdimësi përdorim fjalën “rivlerësim”. Cila do të ishte më e përshtatshme? Nëse doni mendimin tim, ne bëjmë rivlerësim, sepse vlerësimin tashmë atë e kanë pasur.

Lidhur me sugjerimin për nenin A, mendimi im është që ky nen mund të përmblihet në një paragraf ku të përcaktohet kufizimi i të drejtave që do të jetë proporcional, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe në një nen të dytë se cilat janë subjektet që i nënshtrohen.

Gjithashtu, do të sugjeroja që paragrafi i dytë i këtij neni, i cili flet për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm, të kalojë te neni “C” që i dedikohet këtij neni.

Gjithashtu, në paragrafin e parë, pajtohem me propozimin e kolegut Majko për të ndarë në një paragraf më vete se cilat do të jenë subjektet që i nënshtrohen këtij ligji, dhe këtë do ta bashkoja me paragrafin 3 aktual, por për sa i përket paragrafit të parë do të doja ta lexonim më shkurt. Nëse më lejoni, unë do të doja të hiqnim disa rreshta, të cilët nuk e dëmtojnë aspak përmbajtjen e këtij neni. Do të doja ta lexonim në një formë të tillë: “Me qëllim që të garantohen në mënyrë të barabartë të drejtat e shtetasve të Republikës së Shqipërisë për t’iu drejtuar gjykatave dhe për të pasur një proces të rregullt ligjor, zbatimi i disa neneve të Kushtetutës, veçanërisht i neneve...” dhe të vazhdojë teksti siç është.

Meqenëse e përmenda këtë, kam një pyetje për ekspertët: kur thuhet: “zbatimi i disa neneve” dhe më pas veçohen disa prej tyre, a nënkupton kjo se, përveç neneve që kemi përcaktuar apo cituar në këtë paragraf, do të ketë edhe kufizim të neneve të tjera?

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

E mbyllim këtu këtë diskutim.

A ka zoti Deville ndonjë mendim?

Reiner Deville – Ky proces verifikimi, që është miratuar për herë të parë nga Komisioni i Venecias, bazohet mbi tri ndryshime. Kemi Nenin 179/b ku prezantohet parimi dhe tashmë kemi edhe kuotacionin e proporcionalitetit, të drejtat themelore dhe transparencën. Neni A edhe njëherë nuk shihet në veçanti nga Gjykata e Strasburgut si rimarrje e parimeve themelore për këtë ushtrim. Ne na nevojitet neni 179/b dhe na duhet të kemi një bazë për këtë shtojcë në këtë Kushtetutë, por sigurisht, nëse doni mund ta kufizoni Nenin 179/b në numrin 1 dhe pastaj të thoni që kjo shtojcë ekziston e pastaj mund të bashkoni Nenin 179/b dhe Nenin A. E kemi bërë një herë dhe u bë mjaft i gjatë. Donim të siguroheshim që të përfshiheshin edhe parimet e përgjithshme, si dhe kufizimet e dukshme. Kemi thënë që në veçanti këto dispozita preken, e kjo do të thotë që mund të gjenden nene të tjera nga ndonjë avokat që shkon në gjykatë në një fazë të mëvonshme. Kjo është edhe arsyeja se përse kemi thënë në veçanti që kjo është e dukshme e

atëhere kemi të bejmë me një çështje mjaft serioze që lidhet me këto të drejta. Sa për fjalët, mund të gjeni ato të përshtatshmet në gjuhën tuaj. Fjala rivlerësim në gjuhën angleze do të thotë kur dikush vlerësohet edhe një herë, ndërsa fjala verifikim (proçes verifikimi) përmban tashmë një lloj rivlerësimi në të. Por mendoj që ju duhet të gjeni fjalën e saktë. Ne gjithnjë kemi thënë që është një fjalë e re shqipe “vetoi”. Tani kjo varet nga ju që të gjeni fjalën më të mirë e ta përmblihdni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se do ta gjejmë një fjalë, mjaft që të jetë: “si në të gjitha rastet”. Pra, të përdoret një term, të mos përdoren dy terma, sepse ka një konfondim, prandaj janë këtu edhe ekspertët, sekretarët teknikë që të gjejnë një term.

E mbyllim këtë pikë të parë.

Kam një pyetje, të cilën nuk arrita ta bëj në nisje të proçesit. Në një ndërhyrje që bëri zonja Vlahutin, kur erdhi në komision, la të kuptohet që ky kapitull është i shqyrtuar nga drejtoritë përkatëse, ligjore të Komisionit European në Bruksel, së bashku me ligjin e posaçëm, a mund të kemi një vlerësim tuajin për këtë fakt, një konfirmim tuajin për këtë gjë?

Rainer Deville – Kjo është e saktë. E gjithë shtojca, si edhe legjislacioni zbatues janë rishikuar dhe diskutuar në Bruksel, në veçanti fusha që i përket opsionit një dhe dy. Situata aktuale kur vijmë tek Neni C është se Brukseli në diskutimet e tij duket se preferon opsionin e parë dhe jo opsionin e dytë. Por unë do të komentoj mbi këtë gjë kur të vijmë e ta shohim. Me të vërtetë monitorohet me shumë kujdes dhe nuk mendoj vetëm nga Brukseli dhe nga Delegacioni i BE-së, por edhe nga kolegët e mi e nga ambasadorët e shteteve anëtare, të cilët i kushtojnë vëmendje të madhe kësaj çështjeje. Brukseli e ka kontrolluar të gjithë dokumentin përse i përket fjalëve dhe kudo që të bëni ndryshime ato do të rikontrollohen përsëri nga Brukseli.

Oerd Bylykbashi– Unë kam një pyetje për zotin Deville. Strukturat përkatëse në Bruksel, a kanë parë version tjetër ose opsion tjetër zgjidhjeje? Nëse shohin një opsion tjetër, a e prekludon çka parë deri sot struktura përkatëse, mundësinë që të japin opinion të dytë po aq pozitiv apo më të mirë? Duke qenë se ky është parlamenti që do ta miratojë më pas të gjithën a mbivendoset ky opinion mbi atë që ka dhënë opinion Komisioni i Venecias dhe kemi për detyrë ne që ta implementojmë së bashku me të paktën 94 vota në parlament?

Fatmir Xhafaj – Në dijeninë time, ky opinion i Brukselit ka ardhur pas Komisionit të Venecias dhe ka reflektuar qëndrimin e Komisionit të Venecias. Po, z. Deville?

Rainer Deville – Të gjitha këto opsione, janë rishikuar nga Komisioni i Venecias, pra Komisioni i Venecias ka rishikuar jo vetëm këtë version, por të gjitha versionet, dhe unë vetë kam qenë në Bruksel duke diskutuar për disa gjëra e për të gjitha këto detaje përsëri. Pastaj patëm edhe një video konferencë, kështu që ata po e ndjekin nga afër këtë çështje, ashtu si edhe unë. Ata janë si një lloj grupi i dytë pune. Bordi i rishikimit madje duke pasur parasysh Komisionin e Venecias po përpiqet që të gjejë një ekuilibër të duhur për Shqipërinë, por sigurisht ata mezi presin rolin e misionit ndërkombëtar monitorues ku do të ketë një rol dhe do ta financojnë atë. Në përfundim, futja e rregullit mbetet gjithnjë një vendim i Shqipërisë. Ju e dini që është një ftesë dhe mund të vendosni çfarë të doni, po ashtu edhe shtetet anëtare pastaj do të marrin vendimin e tyre për të. Sigurisht ky mbetet një proces negociate dhe dakordësie midis palëve, dhe në fund është parlamenti shqiptar që do të vendosë. Kjo është shumë e qartë.

Oerd Bylykbashi – Po, zoti Devil, në fakt, ky parlament e ka shprehur vullnetin që në momentin kur jo vetëm kemi ratifikuar një numër dokumentesh, por kemi bërë edhe kërkesën për anëtarësim, kështu që besoj se jemi në të njëjtën linjë. Po, monitorimi na duhet, dhe në propozimin tonë, i njëjti është, por besoj se zgjidhjet mund të jenë dhe të tjera nga ata që keni parë ju.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

U qartësuan të gjithë në këndvështrimin respektiv.

Neni B. “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit”.

Zoti Bylykbashi. Po, zonja Hysi. E keni gati. Dakord.

Oerd Bylykbashi - Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

1. Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit udhëhiqet nga Komisioni Europian dhe krijohet me qëllim mbështetjen e procesit të rivlerësimit në bashkëpunim me partnerët në kuadrin e integritimit europian dhe bashkëpunimit Euroatlantik.

Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit është përgjegjës për monitorimin e të gjithë procesit të rivlerësimit dhe për realizimin e procesit të rivlerësimit për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi.

2. Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit përbëhet nga vëzhgues ndërkombëtarë, të cilët fillojnë veprimtarinë pasi i njoftohen Presidentit të Republikës.

3. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit rregullohet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi. Kompetencat e Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit përcaktohen nga dispozitat e kësaj pjese dhe nga ligji. Privilegjet e anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit rregullohen sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, si dhe Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961. Statusi i tyre rregullohet nga kjo pjesë dhe nga ligji i dalë në bazë dhe për zbatim të saj në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.

4. Vëzhguesit ndërkombëtarë janë anëtarë me jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar apo prokuror në sistemin e drejtësisë të vendeve të tyre përkatëse. Mandati i vëzhguesit ndërkombëtar ndërpritet nga Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të rënda.

5. Vëzhguesit ndërkombëtarë ushtrojnë këto detyra dhe kompetenca:

a. Kryejnë procesin e rivlerësimit për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese; anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi. Ata zbatojnë për aq sa është e mundur rregullat e vlerësimit në shkallë të parë të funksionarëve të tjerë.

b. Marrin menjëherë të gjitha informacionet, të dhënat për persona dhe dokumente të nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe shkallët.

c. Paraqesin gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga organet e rivlerësimit. Lidhur me këto gjetje vëzhguesit ndërkombëtarë mund të kërkojnë që organi i rivlerësimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitete të huaja ose persona privatë sipas ligjit.

d. I japin Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rekomandimin me shkrim për të paraqitur ankim. Kur inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të mos e ndjekë këtë rekomandim të dhënë nga Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit duhet të informojë me shkrim arsyet e vendimmarrjes.

Këtu mbaron ky nen i propozuar nga ne.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë jam dakord që neni “b” duhet të rregullojë Misionin Ndërkombëtar të Monitorimit. Unë nuk kam vërejtje për elementet që përmban çdo paragraf i këtij neni. Kam disa sugjerime redaksionale. Njëkohësisht, kam edhe një pyetje lidhur me vëzhguesin ndërkombëtar.

Në paragrafin 4 fjalia fillon në njëjës ku thuhet “vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra dhe kompetenca”. Në vijim flitet në numrin shumës. Mund të jetë problem përkthimi dhe mendoj që duhet të jetë problem përkthimi, por mund të jetë edhe problem, që duhet ta sqarojmë për ta ditur.

Pyetja është: Vëzhguesi ndërkombëtar do të veprojë si individ apo si grup ekspertësh? Nëse do të veprojë si individ, i bie të redaktojmë të gjitha detyrat e përcaktuara në germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të shprehen në njëjës, për të kuptuar që këto i ka çdo ekspert i huaj ndërkombëtar si individ.

Lidhur me titullin do të preferoja që fjalët “operacion ndërkombëtar i monitorimit” të ndryshojnë. Të gjejmë një shprehje më të përshtatshme “mision” ndoshta, “asistencë”, sepse fjala “operacion” nuk është edhe aq shumë diplomatike.

Gjithashtu, kam një sugjerim redaksional të pikës së parë, të paragrafit të parë, i cili mund të përmblihet shumë mirë dhe të qartësojë shumë mirë misionin. “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit krijohet për të mbështetur procesin e rivlerësimit të monitorimit dhe të mbikëqyrjes së gjithë procesit të rivlerësimit. Ky mision udhëhiqet nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me partnerët në kuadër të integritimit evropian dhe bashkëpunimit euroatlantik dhe vëzhguesi ndërkombëtar emërohet pasi i njoftohet Këshillit të Ministrave”.

Në këtë mënyrë shmangim në të gjithë tekstin përdorimin shpesh të fjalës “operacion ndërkombëtar i monitorimit”.

Elementet që janë brenda nuk jam dakord. Duhet të jenë të gjitha, sepse duhet qartësuar shumë mirë pozicioni, detyrat dhe kompetencat që kanë. Janë thjesht redaksionale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Për ta përmyllur zoti Deville, urdhëroni!

Rainer Deville – Në veçanti, ky nen është parë nga Brukseli fjalë për fjalë. Për shembull, fjala “operacion” përkundrejt fjalës “mision” është diskutuar për ditë të tëra, sepse sipas Bashkimit Evropian një mision është diçka ku Parlamenti Evropian ka një rol për të votuar lidhur me të. Dhe kjo sigurisht nuk është ajo që ne kemi në mendje. Kjo është arsyeja përse fjalët “marrëveshje ndërkombëtare” përkundrejt “ujdi ndërkombëtare” diskutohen sepse ata do të përdorin një lloj projekti, siç është EURALIUS e pastaj ky nuk është një mision, por është një operacion. Në fjalorin e BE-së ujdia nuk bazohet domosdoshmërisht mbi një marrëveshje, por një mosmarrëveshje mund të mos përfundohet sepse ekziston. Ndoshta në këtë nen nuk duhet të

ndryshoni shumë gjëra, sepse gjëja më e rëndësishme është që ju jeni të përfshirë dhe duhet të respektoni BE-në. Ose duhet të ndryshoni në Nenin 1, në fund kur themi “misioni monitorues ndërkombëtar do të emërojë vëzhguesit e misionit” – kjo duhet të ndryshohet në “komisioni i BE-së emëron në kornizën e vëzhguesve ndërkombëtarë”. Arsyeja për këtë ndryshim është se operacioni ndërkombëtar monitorues nuk është domosdoshmërisht organi ligjor kontraktues kur vijmë tek pjesa e zbatimit. Deri më tani ata e kanë planifikuar dhe e dinë se si do të funksionojë dhe për këtë arsye emërimi nuk bëhet nga operacioni ndërkombëtar monitorues, por në kornizën e tij. Paragrafi 4 nuk thotë se sa vrojtues ndërkombëtarë do të veprojnë, kjo mund të ndryshojë; në momentin e parë do të ketë më shumë monitorues ndërkombëtarë, ndërsa më vonë, ndoshta një monitorues ndërkombëtar do të atashohet pranë çdo komisioni. Por duhet të rradhisim në numrin 4/b fjalën “ai...”. Duhet të fillojë me këtë fjalë edhe pse nuk duket mirë, por në aspektin e tekstit ligjor është më e saktë. Ndonjëherë vrojtuesit ndërkombëtarë do të lëshojnë rekomandime për Ombudsmanin. Në fillim, në paragrafin 4/b ne kishim vënë “misioni ndërkombëtar monitorues” që ishin edhe fjalët tona të para dhe pastaj kjo u anulua e duhet të jetë koherente në formulimin e fjalëve me A, C dhe D.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Smibert ka kërkuar fjalën.

Jon Simbert – Unë do doja të bëja një dy komente, përsëri nga pikëpamja e dy partnerëve që do të jenë pjesëmarrës, BE-së dhe SHBA-së. Do doja të thoja që kjo është diçka që jo vetëm ku Brukseli ka një përfshirje të madhe, por të dy partnerët ndërkombëtarë kanë një sasi të caktuar të ligjeve të tyre, pritshmëritë dhe sistemet e tyre, të cilat e kufizojnë shkallën e ndërveprimit midis njëri tjetrit. Një pjesë e kësaj ngacmohet nga përvoja e misioneve ndërkombëtare në Kosovë, Bosnje dhe vende të tjera, ku shkalla e përfshirjes së vrojtuesit dhe monitoruesit ndërkombëtarë shkon deri në pasjen e kompetencave ekzekutive, për shembull. Pra, kjo gjë është parë me mjaft kujdes, duke e pëmirësuar deri në masën ku gjithçka të jetë e qetë. Duke shkuar më tej, si në propozimin tjetër, nuk ka për të qenë thjeshtë diçka që unë e di që SHBA-ja do të jetë e gatshme të bëjë dhe do të thoja që BE-ja nuk do të donte të merrej me këtë gjë. Çdo model që do të mbështetej në këtë gjë, nuk do të përjetësohej kurrë, sepse nuk do të kishit partnerë për ta bërë. Prandaj, doja t’i hidhja gjërat në tavolinë e të thoja që kjo gjë është parë me kujdes, rradhitja e fjalëve po ashtu është parë me kujdes edhe nga njerëzit tanë në Uashington në seksionet tona, për t’u siguruar që gjithçka përputhet me atë që bëjmë. Edhe një

herë, kontrollojeni materialin dhe çdo ndryshim që do të bëhet do të shihet me kujdes në Bruksel dhe Uashington për të parë nëse do të biem dakord ta zbatojmë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se ishte i qartë për të gjithë kolegët se cili është pozicioni i ekspertëve ndërkombëtarë.

Neni “c”. Dispozita të përgjithshme për komisionin e pavarur të kualifikimit dhe kolegjin e posaçëm të kualifikimit.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me këtë, siç e thashë në fillim, mendoj se si pjesë e asaj që ne kërkojmë, thjeshtimi i sistemit bëri që sistemi të funksionojë në mënyrë integrale. Nga tani e tutje do të propozoj dy nene.

Vlerësimi i posaçëm i organeve të rivlerësimit.

1. Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit sipas rregullave të përcaktuara në këtë pjesë bën rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të zgjedhur në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi.

2. Në rast se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese apo anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, Kuvendi vendos shkarkimin e tyre sipas rekomandimit të Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Konstatimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese bëhet me dekret të Presidentit të Republikës.

3. Procesit të rivlerësimit nga Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit përpara fillimit të detyrës i nënshtrohen të gjithë personat, që zgjidhen në funksionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe inspektorit të Lartë të Drejtësisë deri në datën 31 dhjetor 2022.

Përfundimi me sukses i procesit të rivlerësimit është kusht për fillimin e detyrës.

4. Nëse anëtarët e zgjedhur në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk kalojnë me sukses procesin e vlerësimit, vendimi për emërimin e tyre konsiderohet i revokuar, sipas rekomandimit të Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe organet e emërtesës të zgjedhin funksionarin e ri.

Neni vijues organet e rivlerësimit:

1. Organet e rivlerësimit janë Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Gjykata Kushtetuese.

2. Procesi i vlerësimit kryhet:

a. Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët e gjykatave të posaçme; nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë; nga gjyqtarët e Shkallës së Parë dhe të Apelit; nga kryeinspektori dhe inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të gjithë ata që ruajnë statusin e gjyqtarit.

b. Nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorin e Përgjithshëm; prokurorët e Prokurorisë së Posaçme; prokurorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme; prokurorët e Shkallës së Parë dhe të Apelit; oficerët e njësisë së posaçme hetimore, si dhe të gjithë ata që ruajnë statusin e prokurorit.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë ndahen në 3 komisione vlerësimi të përhershme me 3 anëtarë secili, që shërbejnë për paraqitjen e çështjeve për vendimmarrje. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë merret pa praninë e anëtarëve që janë në përbërjen e komisionit përkatës vlerësues.

4. Kundër vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Kushtetuese, të drejtën për të paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese e ka edhe inspektori i Lartë i Drejtësisë me rekomandimin e Komisionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

5. Organet e rivlerësimit i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për ngritjen e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni, si dhe të procesit të rregullt ligjor.

6. Anëtarët e organeve të rivlerësimit, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre organeve, sipas ligjit, nënshkruajnë deklaratë me shkrim me të cilën autorizojnë kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, kontrollin periodik të llogarive dhe transaksioneve financiare dhe heqjen dorë nga e drejta e fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.

7. Organeve të rivlerësimit dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë u caktohet buxhet personel dhe mjedise të mjaftueshme, për të kryer funksionet e tyre sipas kësaj pjese.

8. Anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe punonjësve të administratës dhe familjarët e tyre u garantohet mbrojtje e nivelit të lartë sipas ligjit.

Fatmir Xhafaj – Për ta qartësuar, do të më lejoni të bëj dy pyetje?

Pyetja e parë: Me këtë që lexuat ju e përjashtoni fare monitorimin ndërkombëtar nga procesi i vlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve?

Pyetja e dytë: Kjo skema që jepni nuk është korporatiste për sa kohë që gjyqtarët bëjnë *vetingun* e gjyqtarëve?

Oerd Bylykbashi – Për çështjen e parë besoj se zgjidhja jonë bën të kundërtën e asaj që thatë ju. Zgjidhja jonë jep mundësinë që Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në rastin tonë komisioni dhe operacioni në draftin tuaj, ta shtrijë efektin e tij monitorues për një periudhë të gjatë tek i gjithë procesi. Pra, do të vazhdojë ta monitorojë të gjithë procesin. Pra, përveçse do të bëjë *vetingun* e organeve drejtuese, do të ndjekë të gjithë pjesën tjetër...

Fatmir Xhafaj – Si e kuptoj unë? Ndoshta e kuptoj gabim.

Ju thonin që monitoruesit ndërkombëtarë bëjnë vlerësimin për disa nivele të larta dhe vëzhgojnë, monitorojnë të gjithë pjesën tjetër, siç janë sot.

Oerd Bylykbashi – Kurse për sa i përket çështjes së dytë që ngritët, e para, përveç të gjitha aspekteve sistematike që bën, optimizon maksimalisht burimet njerëzore që kemi. I japim kompetencat që në fakt pas kalimit të periudhës tranzitore KLGJ-ja dhe KLP-ja do t'i ketë kompetencë, që në fakt KLGJ-ja dhe KLP-ja pas miratimit të këtyre dispozitave që propozoni ju, do t'i bëjë për të ardhmen, por nuk do t'i bëjë për të shkuarën. Pra, eliminojmë publikimin e funksioneve. Por vetëm pas një *vetingu* rigoroz nga ndërkombëtarët, këto organe do të marrin përsipër të kryejnë këtë detyrë.

Çfarë bëjmë tjetër? Ne, për herë të parë, me këto amendamente kushtetuese, në atë që besoj se jemi të gjithë dakord, po krijojmë dy organe ndryshe nga sa i kemi deri më sot. KLD-ja ikën dhe vjen KLGJ-ja, që kalon edhe mbi Gjykatën e Lartë. Sot nuk është kështu. Po flasim për dispozitën, e cila duke filluar nga shtatori 2017 do të ketë një vit kohë. Nuk është asgjë.

Ne kemi një institucion sot, KLD-në, që është i ndryshëm nga KLGJ-ja, kur të gjithë biem dakord që duhet të jetë. Pra, duhet të jetë mbi të gjitha nivelet e gjykatave përfshi edhe Gjykatën e Lartë.

Kemi KLP-në, e cila është në një nivel krejt tjetër nga ai që është sot. Nga një organ këshillimor do të jetë organi që garanton pavarësinë, përgjegjshmërinë e sistemit të prokurorisë, i barazvlefshëm në format dhe në mënyrë funksionimi të dyja si organe.

I kemi me mandat të përcaktuar në kohë. Ashtu është edhe sot, por mbi të gjitha me funksionim me kohë të plotë. Sot nuk e kemi kështu. Për rrjedhojë, jemi duke krijuar organe që janë vërtet në majën e sistemit, por duke u dhënë edhe një kompetencë të plotë, ne po u krijojmë identitetin dhe autoritetin e plotë duke i shkëputur nga pjesa tjetër e piramidës. Pra, u japim që në fillim atë që është nën monitorim, atë që është kompetenca e tyre, disiplinimin e niveleve më poshtë. Pra, janë në gjendje ta bëjnë të shkëputur nga korporatizmi.

Nga ana tjetër, nëse këta bëjnë diçka gabim, është një organ i tretë i sistemit, Gjykata Kushtetuese, që do të shqyrtojë ankimet ndaj tyre.

Për ta mbyllur, dy organe që janë në majë të dy piramidave me këtë lloj autoriteti institucional kushtetues, janë në gjendje t'i qëndrojnë përballë edhe Kryeministrit që i bie telefoni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Për nenin “c” nuk kam komente në përmbajtje. Kam disa sugjerime redaksionale.

Fatmir Xhafaj – Më fal, ju për cilin jeni?

Vasilika Hysi – Atë do të them. Neni c, vetëm për pikën 6 që ka dy opsione. Opsioni i parë është i grupit të ekspertëve të nivelit të lartë me disa ndryshime të bëra po nga ekspertët e huaj. Pastaj kemi një opsion të dytë të sjellë.

Në radhë të parë, kam një pyetje për opsionin e dytë, i cili duket më i detajuar dhe ka më shumë hallka. Në rast se ju në opsionin e dytë i keni dhënë të drejtë Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit të heqin nga lista që dërgon komisioni i përzgjedhjes, nga një kandidat dhe këta duhet ta bëjnë këtë proces, sepse brenda 7 ditëve lista i dërgohet Kuvendit, kush do t'ia dërgojë listën Kuvendit, Presidenti dhe Kryeministri, apo komisioni përzgjedhës?

E bëj këtë pyetje, sepse është shumë e rëndësishme ecuria e procesit më tej. Në rast se institucionet nuk bëjnë këtë heqje nga lista, secili nga një kandidat në këtë kuadër, lista e propozuar nga komisioni përzgjedhës konsiderohet përfundimtare.

Se cili do të jetë opsioni i parë apo i dytë, mendoj se është një zgjidhje që nuk mund ta jap vetëm unë. Mua më pëlqejnë të dyja opsionet, në kuptimin që të dyja kanë specifika. E veçanta e opsionit të dytë për paragrafin 6 është se ka një ndërhyrje më të madhe të vëzhguesve

ndërkombëtarë dhe ndoshta kjo jep garanci për shqetësimet që mund të kenë kolegët dhe koleget e opozitës, por edhe opsioni i parë ka përsëri asistencën ndërkombëtare.

Fatmir Xhafaj - Te versioni i dytë e keni, që në rast se Kryetari i Kuvendit nuk e hedh shortin, në rast se ky nuk e dorëzon listën, sepse flitet për Presidentin, për Kryeministrin, për Kryetarin e Kuvendit, mendoj se duhen hequr në Kushtetutë. Duhet ta marrim të mirëqenë. Nuk mund të mendohet ai të mos e bëjë këtë gjë, sepse bëhet fjalë për një përgjegjësi kushtetuese.

Në disa raste përdoret numri njëjës dhe në disa raste përdoren në numrin shumës. Jam i bindur që është çështje përkthimi, që mund të rregullohet. Janë edhe dy-tri gjëra teknike, por po i lë me shkrim.

Zoti Deville, urdhëroni!

Rainer Deville - Në këtë opsionin ngjyrë blu, ju shihni diskutimin që është zhvilluar mes ndryshimeve që ekzistojnë midis opsionit të dytë dhe të parit, që ka të bëjë me rolin e misionit ndërkombëtar monitorues, i cili bëhet edhe më i rëndësishëm në opsionin e dytë. Në bazë të diskutimeve të fundit që kam pasur me Brukselin edhe për këtë çështje, duke pasur parasysh që Brukseli e kishte diskutuar dhe preferuar atë për një farë kohe, tani po e rishikon edhe një herë opsionin e parë, që i jep më shumë përgjegjësi autoriteteve shqiptare. Meqënëse Shqipëria është një vend kandidat, ka një pritshmëri të caktuar që politikanët shqiptarë janë mjaftueshmërisht të pjekur për të treguar që mund ta bëjnë këtë ushtrim vetë, pa patur nevojën që shumica të jenë monitorues ndërkombëtarë, dhe kjo është diçka që Shqipëria duhet ta demonstrojë. Njëri nga diskutimet që kemi pasur lidhur me opsionin e parë është edhe koha që duam që kur këta persona aplikojnë për t'u bërë anëtarë të këtyre organeve verifikuese, të vlerësohen edhe vetë. Dhe kjo është arsyeja që duhet të dorëzojnë deklaratat mbi asetet dhe çështja që ngrihet është se kush i kontrollon këto. Në fund, sigurisht që është e bazuar mbi rekomandimet e operacionit ndërkombëtar monitorues dhe nga ata që vendosin sipas opsionit një, është parlamenti me maxhorancën që duhet të gjeni. Kur po shkruanim opsionin një, paragrafi 6, këta katër muaj nevojiteshin për të marrë të gjithë informacionin, madje edhe nga jashtë shtetit lidhur me deklaratat e aseteve. Çështja shtrohet nëse do të mund t'i shkurttonim këta katër muaj dhe pastaj të jepnim një periudhë më të gjatë në paragrafin 7 për vlerësimin e listës madje edhe nga misioni ndërkombëtar monitorues. Këto dy vonesa korrespondojnë me njëra-tjetrën. Nëse doni që t'i jepni një rol më të madh hapit të dytë, edhe për pjesën e vlerësimit e nëse

nuk doni që të mbështeteni tërësisht në pjesën pasuese, atëherë mund të thoni që kjo listë është dërguar më herët, por prapë dikush duhet të bëjë vlerësimin e deklaramit të aseteve dhe pjesa më e madhe e kohës që nevojitet, me sa e kemi kuptuar, ka të bëjë me verifikimin e aseteve që gjenden jashtë, që mundësisht janë edhe asetet më interesante. Për këtë arsye na nevojitet kohë. Nëse doni ta shkurtoni kohën në numrin 6, pra periudhën katër mujore, duhet t'i kushtoni më shumë kohë paragrafit 7 që është edhe pjesa teknike që tregon se si bëhet krahasimi për këtë vlerësim.

Fatmir Xhafaj- Shumë faleminderit!

Pandeli Majko – Kam vetëm një opinion.

Unë bashkohem me ato që tha eksperti ndërkombëtar, por mendoj se këtu nuk shtrihet shumë problemi i maturimit, por i besimit të palëve. Duke qenë se opsioni i dytë krijon një besim më të mirë midis palëve, si pasojë edhe e pozitës së ndërkombëtarëve, unë propozoj që të shihet me këtë sy opsioni i dytë dhe do të isha në favor të opsionit të dytë, pasi bëhet fjalë për fazën fillestare të veprimit të reformës, e cila, sigurisht, do të kërkojë garanci të dyanshme dhe një arbitrazh të fortë. Prandaj, edhe në funksion të besimit të fillimit të procesit të reformës së drejtësisë, mendoj se opsioni i dytë i pikës 6 do të ishte më pozitiv, megjithatë jam i hapur që ta gjykoni ju në fund fare. E them jam i hapur jo sepse do të vendosni në mënyrë fundore në çdo rast ju, por sidomos në këtë rast, është një marrëdhënie që fillon nga ju, nga BE-ja në drejtim të Shqipërisë dhe jo e kundërta, prandaj e thashë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Megjithatë duhet mbajtur në konsideratë fakti ...

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Unë besoj se kjo që kemi ndërtuar ka marrë një lloj forme të caktuar dhe debati e ka ndihmuar. Jam në një mendje me ekspertët dhe besoj se edhe në Bruksel po të njëjtën logjikë kanë pasur, që ne njëkohësisht edhe ndërtojmë reformë, por edhe maturohemi. Ideja që kemi për prezencën e ndërkombëtarëve, që kalon kufijtë, na çon shumë pas në kohë. Në qoftë se do ta kishim bërë këtë në vitin 1990, ndoshta do të kishte pasur pak kuptim, por sido që të vijë puna, me gjithë problematikën e madhe që është akumuluar, është akumuluar eksperiencia edhe negative, edhe pozitive.

Në kemi një sistem të cilin po përpiqemi shumë ta ribëjmë, por sa më e përmbajtur të jetë prezenca ndërkombëtare aq më të përgjegjshëm e bënë sistemin që të ecë me këmbët e tij. Ndërsa kjo lloj varësie apo prezenca shumë e shtuar ndërkombëtare nuk e ndihmon procesin e reformimit të përvetësimit të sistemit, kështu që unë, personalisht, e gjej të ekuilibruar versionin e parë dhe do ta mbështesja me shumë kënaqësi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Gjithsesi besoj se biem në një emërues të përbashkët që dy zotërinjtë, si ekspertë dhe si ndërkombëtarë e thanë qartazi. Në fund të fundit, ky aneks është bashkëjetesa e dy vendimmarrjeve: vendimmarrjes sonë, si ligjvënës të parlamentit shqiptar, por absolutisht kërkon mirëkuptimin e Brukselit dhe të Uashingtonit, kështu që kjo është diçka që nuk mund të bëhet vetëm nga ne, por nuk mund të bëhet as vetëm nga ata. Kështu që çdo lëvizje në këtë gjë duhet të jetë shumë e kujdesshme.

Unë jam dakord me ju, sepse janë dashur muaj të tërë që Brukseli, në radhë të parë, drejtoria juridike e KE-së ka punuar për këtë projekt, por, gjithashtu, edhe Uashingtoni, siç e tha zoti Smajber është angazhuar për ta mbështetur këtë proces dhe, gjithashtu, ka dhënë jo vetëm kontributin, por ka marrë edhe përgjegjësinë për ta bashkëndarë këtë angazhim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni diçka shtesë për pikën “c”?

Oerd Bylykbashi – Besoj se ndajmë të njëjtin opinion: roli që do të ketë komponenti ndërkombëtar është absolutisht themelor. Ne mendojmë se efektet e kësaj shtrihen edhe më thellë sesa ç’është drafti aktual. Pa diskutim që nuk është çështje vetëm e vullnetit tonë, por edhe e dakordësisë së përbashkët me këta partnerë, për të gjetur zgjidhjen më të mirë dhe më funksionale. Në këtë aspekt për ato që janë të domosdoshme për t’u koordinuar dhe rakorduar, besoj se do të gjenden zgjidhjet më të përshtatshme për këtë.

Fatmir Xhafaj – Me sa duket, edhe ju po reflektoni pak. Kjo është pozitive.

Dakord. Neni “ç” “Rivlerësimi”.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me këtë, ne propozojmë një nen të titulluar “Rregullat e përgjithshme të procesit të posaçëm të rivlerësimit”. Në logjikën tonë ky është neni numër 2, por nuk ka rëndësi, pra po lexoj nenet që i përkojnë draftit tuaj, por në renditjen tonë ka një strukturë ndryshe.

Atëherë, ne kemi një nen që e titullojmë “Rregullat e përgjithshme të procesit të posaçëm të rivlerësimit”.

1. Të gjithë funksionarët e parashikuar në nenin 179/2 të Kushtetutës i nënshtrohen procesit të posaçëm të rivlerësimit, që përfshin vlerësimin e aftësive profesionale, vlerësimin e ligjshmërisë së pasurisë si dhe vlerësimin e integritetit. Organi përgjegjës për rivlerësimin merr vendim bazuar në shqyrtimin e njëres prej dosjeve të rivlerësimit ose bazuar në vlerësimin tërësor të të tre komponentëve të rivlerësimit dhe të informacionit të siguruar.

2. Nëse një nga funksionarët e përcaktuar në nenin 179/2 të Kushtetutës përfundon me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e posaçëm të rivlerësimit, ai nuk i nënshtrohet më procesit të posaçëm të rivlerësimit. Pas përfundimit të këtij procesi, përgjegjësia e tij ligjore dhe disiplinore për rastet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji përcaktohet sipas rregullave të përgjithshme në pjesët e tjera të Kushtetutës.

3. Procesi i posaçëm i vlerësimit bëhet sipas një kalendarit të miratuar paraprakisht sipas kësaj radhe preferenciale:

a) anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi.

b) gjyqtarët e gjykatave të posaçme dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

c) gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

d) gjyqtarët dhe prokurorët e Apelit si dhe inspektorët dhe kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

e) gjyqtarët dhe prokurorët e Shkallës së Parë, si dhe të gjithë ata që ruajnë statusin e gjyqtarit apo të prokurorit.

4. Çdokush ka të drejtë të kërkojë vlerësimin e tij të posaçëm përpara radhës së përcaktuar.

5. Subjekti gjatë procesit të vlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe procesi i vlerësimit ndërpritet menjëherë. Nëse subjekti i vlerësuar jep dorëheqjen, ai përfiton menjëherë nga e drejta e pensionit sipas ligjit në fuqi.

Funksionarët që tërhiqen nga detyra, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në datën e zbatimit të kësaj pjese, nuk mund të emërohen në një nga funksionet e parashikuara në nenin 179/2 të Kushtetutës për një periudhë 10-vjeçare nga momenti i dorëheqjes.

6. Organet e rivlerësimit kanë akses të plotë për çdo të dhënë apo informacion që i shërben realizimit të procesit të rivlerësimit, duke përfshirë edhe dosjet e trajtuara nga funksionari në vlerësim. Ato mund të urdhërojnë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me këtë ligj.

7. Çdo organ shtetëror si dhe çdo person fizik apo juridik ka detyrimin të vendosë në dispozicion të organeve të rivlerësimit çdo të dhënë, akt apo informacion të kërkuar si dhe të lejojë akses të plotë në bazën e tyre të të dhënave.

8. Organet e rivlerësimit gjatë realizimit të procesit të rivlerësimit mund të marrin në shqyrtim edhe të dhëna, fakte apo informacione të ardhura nga publiku apo të bëra publike në media, duke reflektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

9. Organet e rivlerësimit gjatë realizimit të procesit të rivlerësimit ndihmojnë dhe kanë të drejtë t'i delegojnë detyra Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Marrëdhëniet midis tyre, në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e procesit të posaçëm të rivlerësimit rregullohen me ligj.

Fatmir Xhafaj – Po.

A ka tjetër?

Po, zonja Hysi, vetëm në mënyrë të përmbledhur, të lutem!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, për këtë nen unë kam 2-3 komente redaksionale për pikën e parë. Meqenëse i gjithë ky proces u referohet rregullave që parashikohen në këtë aneks, do të ishte mirë që ky paragraf të lexohet si më poshtë vijon:

“Të gjithë zyrtarët e parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 1 i Kushtetutës rivlerësohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në Shkallë të Parë dhe nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit në Shkallë të Dytë. Ata i nënshtrohen vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësisë procedurale sipas parashikimeve të bëra në nenin d, nenin dh, nenin “e” të këtij aneksi”.

Në këtë mënyrë e pastrojmë dhe qartësojmë pa ndërprerje, pra ky është problem redaksional.

Në paragrafin e dytë nuk kam komente. Për paragrafin e tretë, gjithashtu, nuk kam komente.

Për paragrafin e 4-të kam një pyetje për ekspertët. Ndoshta është problem redaksional, apo përkthimi, ndoshta nuk e kam kuptuar unë mirë, por në paragrafin 4 u jepet e drejta disa hallkave të verifikojnë, të vlerësojnë, të intervistojnë, pra të kryejnë një sërë veprimesh lidhur me rivlerësimin e gjyqtarëve. Pyetja ime është: Do ta kenë të drejtën për të shqyrtuar deklaratat e të vlerësuarve, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit apo këtë mund ta ketë edhe personeli i këtyre dy komisioneve? Nëse do t'i lihet personelit, pra përveç komisionit si komision, besoj se kjo duhet të jetë një detyrë e deleguar dhe duhet thënë qartë në Kushtetutë, pra të mos krijojmë një konfuzion që secili të bëjë shqyrtim të deklaratave për të shkuarën dhe të intervistojë personat. Ndoshta ky mund të jetë problem përkthimi.

Do ta doja në mënyrën si është në shqip. Nuk e di sesa varianti juaj në anglisht e evidenton këtë.

Nga mënyra si është shkruar më krijohet ideja se ka një ndërthurje te procesi i rregullt ligjor. Rezulton që komisionerët publikë, pra prokurorët, thënë me fjalë të tjera, kryejnë të njëjtat veprime, siç kryen Komisioni i Pavarur, si komision, Kolegji dhe çdo anëtar apo personel, sikurse janë edhe anëtarët dhe vëzhguesit ndërkombëtar. Pra, të 6-ta këto hallka kryejnë të njëjtat veprime, të paktën në shqip rezulton e tillë. A mos do të ishte e nevojshme të sqarohesha se këto 6 hallka do të kryejnë të njëjtin veprim, apo do të jetë vetëm Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji, apo anëtarët dhe vëzhguesit ndërkombëtar do t'i kenë këto të drejta dhe më pas mund t'ia delegojmë, por duhet thënë se duhen deleguar veprime të veçanta te stafi i tyre.

Kjo për sa i përket pikës 4.

Lidhur me paragrafin e 5-të, unë kam një pyetje që mund të jetë ndoshta përsëri problem përkthimi.

Në radhë të parë mendoj se duhet t'i referohemi që në zbatim të ligjit të posaçëm, sepse duhet të ketë një ligj. Nëse nuk janë thënë në një ligj të posaçëm, duhet të themi: “në zbatim të këtij aneksi”, pra në të gjithë paragrafët duhet të themi: “sipas këtij ligji, aneksi apo edhe ligji të posaçëm”. Nëse do t'i referohemi edhe aneksit, edhe ligjit të posaçëm, kjo duhet saktësuar në çdo paragraf për të ditur se për çfarë po flitet, nuk janë taksative vetëm këto rregulla, mund të ketë rregulla edhe në ligj të posaçëm dhe këtë duhet ta mbajmë në konsideratë. Kushtetuta ka shumë të drejtë ta delegojë, por te paragrafi 5 ju thoni që personeli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit, pra njëri ose tjetri, përgatit dosjen. Apo secili kur ka në shqyrtim ose po shqyrton në Shkallë të Parë apo në apel procesin e rivlerësimit? E

them këtë, sepse kam idenë se duhet të jetë problem përkthimi, pasi në shqip në fjalinë e parë e kemi: “Komisioni i Kualifikimit dhe Kolegji”, pra e bëjnë të dyja paralel këtë gjë, pavarësisht se një dosje mund të jetë përgatitur në Shkallë të Parë. Ndërsa më poshtë, te fjali e fundit thuhet: “Komisioni i Pavarur ose Kolegji merr vendim të bazuar në njërin prej dosjeve” e kështu me radhë. Kjo duhet qartësuar që të mos krijojmë idenë se të njëjtën punë ta bëjnë të njëjtat institucione, pra të mos ketë mbivendosje dhe të mos jenë të qarta kompetencat, pra të dimë se kush bën, çfarë. Kjo besoj i takon këtij aneksi ta përcaktojë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Mbaruam edhe me pikën “ç”. A ka ndonjë koment?

Po, zoti Deville.

Rainer Deville – Unë do të doja të përgjigjesha shkurt. Komisioni funksionon së bashku me personelin, ku personeli vepron mbi udhëzimet e Komisionit dhe kompetencave deleguese të Dhomës së Apelit. Sigurisht që çdo akt i vetëm duhet të kalojë përmes Komisionerit, e kështu Komisioneri kërkon që të merret dosja e së kaluarës penale dhe dikush tjetër e ekzekuton këtë detyrë. Kjo është ajo që doja të thoja. Ligji zbatues është rregulluar në Nenin 179/b, pika 7, ku ka edhe një dispozitë të përgjithshme që na jep mundësinë që gjithçka që është në shtojcë mund të rregullohet më tej në legjislacionin zbatues. Prandaj, kjo është arsyeja që e kemi vënë aty, në fillim, e kështu nuk kemi nevojë ta përsërisim kudo. Ndonjëherë, kur kemi parë se kishte nevojë të rregullohej, e kemi bërë këtë gjë, por ajo që lejohet në përgjithësi për ligjin zbatues të verifikimit gjendet në Nenin 179/b, numër 7.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin D, të numërtuar me germa: “Vlerësimi i pasurive”.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Vlerësimi i pasurive është nen që ne e kemi titulluar “Vlerësimi i ligjshmërisë së pasurisë”, që ka për qëllim:

1. Verifikimin nëse funksionari zotëron në pronësi apo në përdorim pasuri më të mëdha nga ajo që mund të justifikohet ligjërisht ose nëse ka refuzuar deklarin, ka fshehur ose ka deklaruar në mënyrë të rreme pasurinë.

2. Funkionarët e përcaktuar në nenin 179/2 dorëzojnë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë për veten dhe për personat e lidhur në përputhje me ligjin dhe i nënshtrohen vlerësimit të ligjshmërisë së pasurisë.

3. Në zbatim të kësaj dispozite, pasuri e justifikuar ligjërisht konsiderohet pasuria e krijuar nga të ardhurat e deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elementet e detyruara të pasurisë së justifikuar ligjërisht përcaktohen me ligj. Subjekti i vlerësuar duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshmërisë së pasurive dhe të të ardhurave.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon komisionit vlerësues pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport mbi ligjshmërinë e pasurive, mbi saktësinë dhe plotësimin e deklaramit si dhe mund të rekomandojë vendosjen e masave disiplinore në përputhje me ligjin.

5. Nëse vlerësohet se funksionari zotëron një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së justifikuar ligjërisht apo refuzon deklaramin, fsheh ose deklaron në mënyrë të rreme pasurinë, ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

6. Në të gjitha rastet funksionari i vlerësuar ka barrën e provës për të provuar justifikimin ligjërisht të pasurisë së tij apo saktësinë e deklaramit të pasurisë. Kalimi i barrës së provës te subjekti i vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe në veçanti jo për procedime të tjera penale.

7. Në rast se merret masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcjell menjëherë të gjitha aktet dhe provat për hetime të mëtejshme pranë Prokurorisë së Posaçme. Në procedimin penal barra e provës i përket shtetit.

8. Nëse subjekti i vlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë ose përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi ose në procedim të tij zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën.

9. Në të gjitha rastet, funksionari i vlerësuar ka barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së tij. Kalimi i barrës së provës te subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe në veçanti jo për procedime penale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Për t’u parë nga ekspertët është se te pika 4 do të propozoja të ndahet fjalia: “Kalimi i barrës së provës te subjektet që vlerësohen të zbatohet vetëm për këtë vlerësim...” dhe pastaj do të shtoja një fjali tjetër: “Barra e provës në procese të tjera administrative ose penale u takon subjekteve proceduese sipas ligjit”.

Shikojeni dhe vlerësojeni në gjykimin tuaj! Është thjesht një redaktim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kryetar, unë nuk kam ndonjë vërejtje në përmbajtje.

Kam dy pyetje dhe një sugjerim, gjithmonë në kuptimin redaksional.

Marrim paragrafin 2.

Në projektligj thuhet: “Subjekti i vlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin”. Kur themi “me ligjin” kemi parasysh ligjin që do të shkruhet enkas për vlerësimin apo për ligjin në bazë të të cilit organizohet dhe funksionon Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive?

Po për këtë paragraf kam një pyetje. “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave” thuhet në projekt, “kontrollon deklaratën e pasurisë dhe ia dorëzon komisionit”. Cilit Komision? Është fjala për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit apo për ndonjë komision tjetër? Kjo duhet saktësuar, për cilin komision bëhet fjalë.

Gjithashtu, nga studimi i neneve “ p”, “dh”, “e” kam konstatuar se 8 herë përdoren dy fjali. Fjalia e parë ka të bëjë me parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore, që i kalon subjektit të vlerësimit.

Parimi i dytë është kalimi i barrës së provës. A është e mundur që këto dy parime, këto dy risi që ka aneksi, të mos përsëriten në këto tre nene, por të kemi një nen përmbledhës dhe t’u referohemi paragrafëve konkret? Pra, të mos përsëritet fjalia: “Zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën”, meqenëse kjo është thënë 8 herë në tre nene.

Gjithashtu, edhe fjalia: “Kalimi i barrës së provës te subjekti i vlerësimit zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe jo për procedime penale”, është përdorur ose është rithënë 8 herë. Në këtë mënyrë ne bëjmë një pastrim, një shkurtim të këtyre neneve dhe i qartësojmë shumë mirë edhe nga pikëpamja e teknikës legislative.

Këto janë dy sugjerimet që unë kisha për kuptimin e redaktimit, por e vlerësoj shumë edhe nga përmbajtja. Këto dy parime po të jenë në një nen më vete janë shumë të dukshme, ndërsa nëpër paragrafë ato humbasin. Këto janë dy risitë në procesin e rivlerësimit që ne i kemi theksuar edhe në kuadër të kufizimit të të drejtave të personit në përputhje me nenin 17 dhe ia vlen t'i kemi në një nen të qartë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, në çdo rast duhet saktësuar mirë e drejta se e kujt është barra e provës për efekt të procesit të vlerësimit dhe kur do të përfshihet në proces administrativ dhe në proces penal, sepse mund të ndodhë që një gjyqtar të ketë tre procese ose një gjyqtar përfshihet në tre procese: në procesin e vlerësimit, në procesin administrativ dhe në proces penal. Në këtë kontekst do të duhet të ndahet qartasi në ligj, që të mos ketë konfondime në zbatim. Kështu e kuptova unë saktësisht, edhe zotin Majko, edhe zonjën Hysi. E tha edhe zoti Bylykbashi këtë, pra për barrën e provës kemi unanimitet.

Rainer Deville – Së pari, në numrin 2 është komisioni kualifikues dhe në numrin 4, për barrën e provës me mënyrën si e kemi shkruar, nuk e dimë se si është në procedura të tjera. Kështu që, nuk mund të them se si mund të jetë në dispozitat e tjera. Pra, më mirë lëreni të hapur dhe thoni negative. Sepse kushdo që e di se ç'mund të ndodhë diku tjetër, ju nuk do të donit ta rregullonit këtu. Ne e vendosim barrën e provës, jo për procedurën penale, por që të jemi në anën e sigurt të Strasburgut, dhe sigurisht ju mund ta vini në nenin “Ç”, si një parim të përgjithshëm, por barra e provës nuk ekziston menjëherë në të njëjtin moment e për të gjitha llojet e tri shtyllave, pra ajo nuk është diçka automatike; vetëm nëse në ndonjërin prej këtyre shtyllave paraqitet një kusht i caktuar, dhe atëherë kemi kthimin e barrës së provës. Pra, nëse e vendosni atë në parimin e përgjithshëm në Nenin “Ç”, kjo gjë nuk ju ndihmon, sepse ende duhet të vendosni në cilën situatë ndryshon kjo gjë e nëse e vini dhe e lexoni më pas nuk bëhet më bindëse. Ju mund të përpiqeni, por nuk është një barrë automatike prove që ndryshon menjëherë në një moment të caktuar; është mjaft e detajuar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Mbaruam me nenin e vlerësimit të pasurisë.

Vazhdojmë me nenin “x”: “Kontrolli i figurës”.

Po, zoti Byllykbashi .

Oerd Bylykbashi – Po, zoti kryetar.

Duhet bërë kujdes, sepse për shembull germa “ç” është e keqkuptueshme dhe ...

Atëherë vlerësimi i integritetit:

1. Funkionarët e përcaktuar në nenin 179/2 i nënshtrohen vlerësimit të integritetit, me qëllim verifikimin e qëndrimeve të tyre ndaj ndikimit apo presionit të jashtëm, veçanërisht mbi marrëdhëniet e tyre të shpeshta dhe të papërshtatshme me palë të përfshira në proceset që kanë pasur në shqyrtim apo me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Marrëdhëniet e tyre të shpeshta dhe të papërshtatshme përcaktohen me ligj.

2. Verifikimi i integritetit bëhet në bazë të vetëdeklarimit dhe prova të tjera të papërshtatshme, duke përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja, sipas rregullave të përcaktuara në ligj. Vetëdeklarimi mund të përdoret si provë vetëm në këtë procedurë dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret në një çështje penale.

3. Nëse funksionari nuk dorëzon vetëdeklarimin, bën deklarime të pasakta, fsheh kontaktet ose vlerësohet se ka pasur marrëdhënie të shpeshta dhe të papërshtatshme me palë të përfshira në procese, që kanë pasur në shqyrtim apo me persona të përfshirë në krimin e organizuar ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

4. Në të gjitha rastet funksionari i vlerësuar ka barrën e provës për të provuar pastërtinë e integritetit. Kalimi i barrës së provës te subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe në veçanti jo për procedime penale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka tjetër? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë ndoshta nuk u shpreha qartë dhe zoti Rajner nuk arriti të më kuptonte, por fjalia që është përdorur këtu për parimin e kalimit të barrës së provës është fjalë për fjalë në çdo paragraf, edhe te neni “dh”. Te paragrafët 3 dhe 4 është fjalë për fjalë, fjali më vete, pra ky është një parim që ne tashmë e pranojmë, që në këtë proces vetingu kalimi i barrës së provës te subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe jo për procedime penale. Kjo duhet thënë, që të jemi korrektë edhe me Gjykatën e Strasburgut.

Gjithashtu, besoj se është e njëjta përgjigje që zoti Rajner dha edhe për paragrafin e dytë të nenit “D” ku thuhet: “Subjektet e vlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë komisionit të pavarur kualifikimin, një deklaratë të detajuar mbi figurën e tyre”. Kështu duhet të jetë, apo jo? Apo duhet të ketë një komision tjetër?

Këtu përmendet fjala “komision”, por nuk përcaktohet se për cilin komision bëhet fjalë, për Komisionin Përzgjedhës apo për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A ka komente? Po zoti Deville.

Rainer Deville – Ndërkohë që është Komisioni ai që e kryen vlerësimin dhe nëse kryhet në shkallën e parë, është Komisioni i Pavaruar për Kualifikimet, dhe për shkallën e dytë është Dhoma e Apelit. Mendoj që mund ta vendosni parimin në nenin “Ç”, si paragrafin e ri 6, nëse doni, dhe kjo do ta shkurtojë atë. Atëherë do të jetë në rregull.

Fatmir Xhafaj - Në rregull!

Ju doktorët e shkencave bashkoheni, kurse ne që nuk kemi titull kemi probleme.

Neni “E” “Vlerësimi i aftësive profesionale”.

Po. Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Vlerësimi profesional:“1) Funkionarët e përcaktuar në nenin 179/2 i nënshtrohen vlerësimit profesional me qëllim verifikimin e aftësive profesionale dhe etike të tyre për të identifikuar përshtatshmërinë e tyre për të ushtruar ose jo detyrën, si dhe nevojat e tyre për trajnim.

2) Vlerësimi profesional përfshin: a) aftësitë profesionale në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, që maten mbi bazën e vlerësimit dhe çështjeve të shqyrtuara prej tyre. Në këtë rast përdoren si tregues aftësitë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, për të analizuar jurisprudencën, qartësinë, strukturën koherente dhe të mirëorganizuar të akteve, si dhe cilësitë e analizës dhe argumentimit logjik; b) aftësitë organizative në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedura gjyqësore dhe hetimore dhe aftësinë për të administruar, sipas funksionit, dosjet gjyqësore, dosjet hetimore dhe dosjet e procedimeve administrative; c) aftësitë etike dhe angazhimit ndaj vlerave të gjyqësorit në drejtim të përkushtimit dhe përgjegjshmërisë në detyrë; ç) aftësitë njerëzore dhe angazhimit profesional në drejtim të aftësisë së komunikimit, aftësisë për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmërisë për të angazhuar në aktivitete profesionale.

3) Vlerësimi profesional shtrihet vetëm për çështjet e trajtuara nga funksionari deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për të gjitha çështjet e trajtuara pas kësaj date vlerësimi

profesional bëhet sipas rregullave të përgjithshme, të parashikuara në pjesët e tjera të kësaj Kushtetute.

4) Nëse nga vlerësimi profesional rezulton se funksionari ka aftësi profesionale të diskutueshme ose ka një praktikë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, por mund të përmirësohet nëpërmjet trajnimit, ndaj tij merret masa disiplinore “e pezullimit nga detyra, si dhe detyrimin për ndjekjen e trajnimit vazhdues për një vit pranë Shkollës së Magjistraturës.”

“Në përfundim të trajtimit funksionari i nënshtrohet testimit, i cili monitorohet nga Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Nëse nuk rezulton kalues në 70% të pikëve të totalit të testimit Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Prokurorisë merr masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5) Nëse nga vlerësimi profesional rezulton se funksionari nuk ka aftësi profesionale të mjaftueshme ose ka një praktikë të vazhdueshme pune të papërshtatshme për pozicionin e tij dhe nuk mund të përmirësohet nëpërmjet trajnimit, ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

6) Nëse funksionari kryen veprime ose mosveprime që pengojnë realizimin e procesit të vlerësimit profesional ai prezumohet se nuk zotëron aftësitë e nevojshme për ushtrimin e detyrës dhe ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

7) Në të gjitha rastet funksionari i vlerësuar ka barrën e provës për të provuar se zotëron aftësitë e nevojshme për ushtrimin e detyrës. Kalimi i barrës së provës te subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe në veçanti jo për procedimin penal.

8) Vlerësimi profesional kryhet sipas një metodologjie, që zbatohet në mënyrë uniforme për çdo rast.”

Këtu mbyllet neni.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka gjë tjetër? Në rregull!

Me sa arrij unë ta kuptoj këtë nen, në pikën 2: “Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e punonjësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kohën kur kryhet ky vlerësim”. Këtu nënkuptohet, besoj unë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në detyrë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo është ideja e këtij neni? Pra, *database*-t që kanë këto dy struktura për të gjithë procesin, a do të vendosen në dispozicion të Komisionit të Posaçëm?

Nga ana tjetër, nëse është kjo, do të duhet të qartësohen se për cilat struktura bëhet fjalë, sepse në këtë rast nuk kemi dy struktura, por kemi tre struktura të tilla, pavarësisht se njëra sot është gati inegzistente, ajo e prokurorisë.

Çështja e dytë ka të bëjë me pikën 1 dhe pikën 5. Ndoshta nga leximi që unë i bëj mund të kem arritur në një perceptim të gabuar, por kam përshtypjen sikur janë gati-gati të njëjta në disa nga paragrafët e pikës 4 dhe 5. Pra, disa nga paragrafët e pikës 4 dhe pikës 5 janë gati-gati të njëjtë dhe ndoshta duhen qartësuar kur të rishkruhet kjo gjë. Janë edhe nja dy-tre gjëra teknike, për të cilat nuk ju ha kohë, sepse janë redaktoriale dhe nuk kanë nevojë për shumë debate, janë thjesht lexim shqip dhe do t'jua dërgoj me email.

Po, zoti Deville.

Rainer Deville – Për të gjithë ushtrimin, ne donim që ta bënim sa më shpejt që të ishte e mundur që të fillonim menjëherë me ditën kur ky ligj dhe legjislacioni zbatues hyjnë në fuqi. Ne ende kemi edhe një ligj të ri statusi me procedurën e re vlerësuese. Elementi i parë i procedurës së vlerësimit është që njerëzve do t'ju kërkohet të dorëzojnë vlerësimin e tyre dhe të propozohen dosje të cilat duhen shikuar, dhe po ashtu, duhet të fillojnë edhe strukturat ekzistuese, sepse ato kanë dosje për të gjithë. Të paktën vlerësimi i fundit që është bërë para shumë kohësh ende ekziston dhe ata mund ta bëjnë përzgjedhjen e informacionit në mënyrë të rëndomtë. Ky fillim lidhur me vlerësimin e kualifikimit dhe testin e aftësive mund të fillojë menjëherë dhe mund të fillojë me strukturat ekzistuese. Gjatë vlerësimit, sigurisht, Komisioni i Kualifikimit gëzon të drejtën të kontrollojë vetë edhe punime të tjera ose në mënyrë të rastësishme, ose siç tregohet nga publiku, që më pas ka referuar ose është ankuar lidhur me diçka e që mund të marrë informacion specifik lidhur me ndonjë lëndë që duhet rishikuar. Kjo është arsyeja që e bëmë në momentin e vlerësimit ku kemi në funksion strukturat e vjetra, sepse në fillim na duhet të fillojmë procedurën. Por kjo nuk do të thotë që kjo strukturë do të marrë vendimin, e as nënkupton që kjo strukturë po i kufizon provat, por për afatin 30 ditësh na duhet të fillojmë menjëherë e nuk na duhet të humbasim kohë.

Sanksionet që mund të vihen ndahen në kategori të ndryshme, kështu që nëse njerëzit kanë një performancë të ulët, por kemi edhe prezumimin edhe mjetin kompensues të të pasurit e informacionin e azhornuar mbi njohuritë, kështu që nuk kemi nevojë t'i pushojmë këta njerëz nga puna. Pra, nëse dikush është jo shumë i mirë, por është në rregull dhe mund të trajnohet, ne i trajnojmë ata. Qëllimi i këtij ligji nuk është që të hiqen nga puna këta njerëz. Ne do të heqim nga

puna vetëm ata persona, të cilët edhe pas trajnimit një-vjeçar do të jenë krejt të padobishëm, pasi shohim që nuk dinë as të lexojnë e as të shkruajnë, e të shkruash gjithë ato budallallëqe në një aktgjykim, kjo nuk do të jetë në rregull dhe Komisioni do të thotë që kjo gjë nuk është e mundur, dhe ky është numri 4. Numri 5, është pastaj kur kemi rastin e një gjyqtari që i shkel rëndë të drejtat e qytetarëve, ndoshta me justifikimin mjaft të sofistikuar, që nuk është në rregull e që në fakt e kthen rastin në anën e kundërt. Nuk duam t'i kemi as këta njerëz që keqpërdorin, kërcënojnë e pakësojnë të drejtat e qytetarëve, që kthehet pastaj në një ushtrim joadekuat të profesionit e këta njerëz duhet të largohen. Pra, kjo është arsyeja që bëjmë dallimin mes dy apo tri grupeve në këtë paragraf.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Smibert!

Jon Simbert – Vetëm sa për të qartësuar. Nëse lexoni paragrafin 3, 4 dhe 5 së bashku, paragrafi 3 dhe 4 janë ata paragrafë që lexohen së bashku. Paragrafi 4 është paragrafi ku nuk ka ndonjë lloj klase dhe që mund ta ndryshojë këtë gjë. Paragrafi 5 është ai që specifikon se këta janë persona që qartësisht nuk na duhen.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Mbetet për t'u riparë, me sa kuptova nga reagimi juaj.

Kalojmë te neni “E” “Vlerësimi në shkallë të parë”.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi - Vlerësimi në shkallë të parë. “1) Komisioni Vlerësues pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pasi përfundon të gjitha proceset e rivlerësimit, njofton funksionarin për rezultatin e vlerësimit dhe i njofton atij datën e shqyrtimit të çështjes nga organi i rivlerësimit.

2) Komisioni Vlerësues, kur e vlerëson të arsyeshme, në çdo rast kur ka dyshime që ndodhet në kushtet e një prej rasteve të marrjes së masës disiplinore para marrjes së vendimit, thërret në seancë dëgjimore funksionarin e vlerësuar dhe i garanton të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova të reja dhe për t'u mbrojtur.

3) Komisioni Vlerësues mund të kërkojë informacion shtesë dhe propozon në mënyrë të arsyetuar marrjen e një vendimi. Funksionarit të vlerësimit i jepet një kopje e raportit që propozon masën disiplinore dhe ai ka të drejtë, brenda një afati të caktuar me ligj, të pranohet ose të kundërshtojë propozimin ose të sjellë prova shtesë.

Komisioni Vlerësues gëzon të drejtën të kërkojë ndihmë nga autoritetet e huaja dhe mund të ndihmohet nga institucionet shqiptare.

4) Pas shqyrtimit të çështjes Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr vendim të arsyetuar sipas njërit nga rastet e mëposhtme: a) funksionari konsiderohet i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës; b) ndaj funksionarit merret masa disiplinore e pezullimit nga detyra dhe detyrimi për ndjekjen e trajnimit vazhdues për 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës; c) ndaj funksionarit merret masa disiplinore shkarkim nga detyra.

5) Kur ndaj funksionarit merret masa disiplinore shkarkim nga detyra, urdhërohet edhe pezullim i menjëhershëm nga detyra derisa vendimi të jetë përfundimtar. Në këtë rast, si dhe në rastin e masës disiplinore të pezullimit nga detyra dhe detyrimi për ndjekjen e trajnimit vazhdues për 1 vit pranë Shkollës së Magjistraturës gjyqtari paguhet në masën 75% të pagës së tij.”

Fatmir Xhafaj - Më falni, i keni bërë bashkë të dyja nenet?

Oerd Bylykbashi - Po janë bashkë me nenin që vjen “Masat disiplinore”.

“Nëse Gjykata Kushtetuese e pranon ankimin, duke shfuqizuar vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pjesa prej 25% të pagës i paguhet subjektit të vlerësuar për të gjithë periudhën e ndërprerjes.

6) Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë shpallet publikisht në çdo rast. Bashkë me vendimin publikohet edhe mendimi i pakicës.

7) Veprimtaria e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë monitorohet nga Komisioni Ndërkombëtar të Monitorimit.”

Këtu mbyllet neni.

Me të drejtë, zoti kryetar, siç edhe ju e konstatuat, ne i bashkojmë këto dy nene në një.

Fatmir Xhafaj - Nga ndërhyrja ime duhet të kuptoni se sa të vëmendshëm jemi ne kur flet opozita.

Oerd Bylykbashi - Unë e vlerësoj shumë, por për këtë nuk jam i sigurt.

Fatmir Xhafaj - A e kupton ? Arritëm sa të mos i besonim vetes dhe thamë: “Prit një minutë, çfarë po ndodh!?”

Oerd Bylykbashi - Unë kuptoj që është më efektive me të lexuar se sa me të shkruar, se pastaj nuk lexohet.

Fatmir Xhafaj - Keni të drejtë! Vazhdoni lexoni ju, por ne u qartësua. Pra, që ta kuptojnë edhe të gjithë kolegët, ne kishim diskutimin e nenit “E” “Vlerësimi në shkallë të parë”, dhe opozita është gjithmonë një hap para kështu që përfshiu edhe nenin “F” “Masat disiplinore”.

A ka ndonjëri diçka për të shtuar për këto dy nene?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - E vura re që i bashkoi të dyja nenet bashkë “E”-në dhe “F”-në. Për nenin “E” nuk kam pyetje, por kam një pyetje për nenin “F” “Masat disiplinore”, ku që në fillim të fjalisë në nenin “F” thuhet: “Masë disiplinore mund të marrë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit.” Pyetja është: pse e parashikojmë Kolegjin e Posaçëm që në këtë nen, kur neni “F” flet për masat disiplinore vetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit? E them këtë, pasi në nenin “G” kemi “Shqyrtimin në Apel” dhe këtu është kompetencë e Kolegjit të Posaçëm. Në vazhdim të këtij neni, tek “E”-ja, ne përsëri kemi thënë për masat disiplinore që merr Kolegji i Posaçëm dhe konkretisht te paragrafi 3.

Pyetja ime është: të dyja komisioneve, edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit edhe Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit, u njihet e drejta të japin masat disiplinore që parashikon neni “F”?

Fatmir Xhafaj - Si e kuptoj unë shqetësimin e zonjën Hysi është: duke përfshirë këtu një organ apelimi për shqyrtimin e ankimit, siç është Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit, në veprimtarinë e komisionit ose duke e bashkëndarë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, rrezikojmë të cenojmë parimin e rëndësishëm, që është parimi i procesit të rregullt ligjor.

Unë kështu e kuptova, por nëse nuk është kështu, atëherë duhet një riformatim fjalie.

Në vazhdim të kësaj, kam edhe diçka tjetër, që e përmendi edhe zoti Bylykbashi në versionin modern të këtij neni kur tha: “Komisioni Vlerësues gëzon të drejtën të kërkojë ndihmë nga autoritet e huaja dhe mund të ndihmohet nga institucionet shqiptare.” Tani kuptohet që po ta lëmë kështu këtë frazë dhe nuk sqarohet në ligjin e posaçëm, kam përshtypjen që mund t’u lërë vend shumë keqkuptimeve. Nuk e di konkretisht se çfarë keni pasur në konsideratë këtu, por, gjithsesi, mendoj se nëse mbetet kështu, do të duhet të ketë një specifikim sipas rregullimit në ligjin e posaçëm.

Po, një koment nga ju.

Rainer Deville – Neni F vetëm përshkruan sanksionin dhe çfarë vjen pas sanksionit, veçantërisht pasi kemi edukimin. Ai bën përshkrimin e kësaj në çështjet e tjera që gjyqtarët e prokurorët mund të kenë trajtuar. Kjo gjë vlen për të dyja shkallët dhe mund të ndodhë që shkalla e parë të vendosë lidhur me masën disiplinore, e mund të ndodhë që edhe shkalla e dytë të vendosë lidhur me masën disiplinore. Që të dyja janë të vlefshme pavarësisht shkallës ku

gjenden rastet. Pra, nuk është diçka e veçantë për shkallën, por ka të bëjë vetëm me sanksionin si të tillë, e prandaj gjendet në Nenin F.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit për vërejtjet që bënë zonjat përkthyes, por duhet të flisni me mikrofon.

Kalojmë te neni “G” “Shqyrtimi në Apel”.

Oerd Bylykbashi - Ne mendojmë ta titullojmë “Ankimi dhe vendimi përfundimtar”.

“1) Kundër vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të bëjë ankim funksionari i vlerësuar ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë pranë Gjykatës Kushtetuese brenda 15 ditëve nga shpallja publike e vendimit. Gjykata Kushtetuese e shqyrton çështjen jo më vonë se 3 muaj nga momenti i depozitimit të ankimit.

2) Gjykata Kushtetuese siguron respektimin e të drejtave themelore të subjektit të vlerësuar brenda kufijve të përcaktuar nga neni 1 i kësaj pjese. Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve nuk mund të shqyrtojë apo vlerësojë parimet e kushtetutshmërisë mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet vetëm te kriteret e përcaktuara në këtë pjesë.

3) Gjykata Kushtetuese, kur është e nevojshme, mund ta shqyrtoj vetë çështjen në themel apo t’i korrigjojë shkeljet procedurale dhe në asnjë rast nuk mund të vendosë kthimin për rishqyrtim të saj pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4) Në përfundim të shqyrtimit të çështjes Gjykata Kushtetuese, në mënyrë të arsyetuar, merr një nga vendimet e mëposhtme: a) pranimin e ankimit të funksionarit dhe konsiderimin e tij si të përshtatshëm për ushtrimin e detyrës; b) pranimin e ankimit të funksionarit dhe marrjen e një mase disiplinore më të lehtë; c) vlerësimin e ankimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe marrjen e masës disiplinore ndaj funksionarit të kualifikuar sipas kësaj pjese, në këtë rast ky vendim merret pasi është respektuar e drejta e vlerësuar e funksionarit të vlerësuar për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe për t’u mbrojtur; ç) mospranimin i ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar, hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht në çdo rast. Vendimi së bashku me mendimin e pakicës publikohen.

6) Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të ankimeve sipas këtij neni.

7) Vendimi përfundimtar për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra nuk përbën shkak për rihapjen automatike të çështjeve të gjykuara apo hetuara nga funksionari i shkarkuar, përveç rasteve kur nga kjo procedurë zbulohen shkaqe për paraqitjen e kërkesës për rishikimin sipas legjislacionit procedural në fuqi.”

Këtu mbyllet ky nen. Për nenin vijues, neni “H” “Dorëheqja”, ne i kemi përfshirë në një nen më parë, e lexova më herët. Kështu që ky është neni i fundit që ne propozojmë.

Fatmir Xhafaj - Të lutem më ndriçon dot, se nuk arrita ta kuptoj dot të gjithë. Ju thatë se monitoruesit ndërkombëtarë monitorojnë Gjykatën Kushtetuese. Po si mund ta bëjë një trupë, cilado qoftë ajo, qoftë edhe ndërkombëtare, të monitorojë Gjykatën Kushtetuese? A ju qëndron kjo juve?

A e lexon edhe një herë, se ndoshta nuk e kuptova mirë.

Oerd Bylykbashi - A doni që t’ju lexoj vetëm atë pikë apo të gjithë nenin?

Fatmir Xhafaj - Jo vetëm atë pikë.

Oerd Bylykbashi – “5) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar, hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht në çdo rast. Vendimi së bashku me mendimin e pakicës publikohen.

6) Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të ankimeve sipas këtij neni.”

Fatmir Xhafaj - Cili është koncepti i monitorimit?

Oerd Bylykbashi - Duke qenë se ne, siç thoni ju, gjatë kësaj periudhe transitore do t’i forcojmë besimin publikut; duke qenë se gjykojmë se e gjithë kjo është një histori nevojë e padiskutueshme, sepse duhet të maturohen institucionet shqiptare në vitin 2016; duke qenë se i kemi dhënë mundësinë këtij komisioni që të bëjë vetingun e Gjykatës Kushtetuese, sigurisht, siç po i japim mundësinë që të monitorojë KLGJ-në dhe KLP-në, që janë maja e sistemit të drejtësisë dhe prokurorisë, po i japim edhe këtë mundësi. Ky është këndvështrimi ynë, nëse ju jeni kundër na e thoni.

Fatmir Xhafaj - Jo, na e sqaro se mbase na bind: çfarë do t’i bëjë Gjykatës Kushtetuese kjo gjë?

Oerd Bylykbashi - Ata monitorojnë këtë veprimtari.

Fatmir Xhafaj - Mbajnë shënime, me një fjalë.

Oerd Bylykbashi - Gjykata Kushtetuese gjatë gjithë veprimtarisë që ushtron, sipas këtij aneksi, do të jetë e monitoruar në veprimtarinë e saj për sa i përket shqyrtimit të ankimeve, jo në detyrën e saj si Gjykatë Kushtetuese, në lidhje me atë që është në kompetencë e saj si Gjykatë Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj - Cili është efekti i këtij monitorimi?

Oerd Bylykbashi - Nëse ju mendoni që së bashku do t'i japim edhe një element shtesë, ne e kemi çuar deri këtu dhe e detajojmë efektin.

Fatmir Xhafaj - Koncepti juaj cili është? Çfarë janë këta? Janë observer?

Oerd Bylykbashi - Minimalisht monitorimi është më tepër se sa vëzhgimi. Observimi është: shiko dhe mbaj shënim, kurse monitorimi ka një karakter më të fortë dhe instruktiv, që është gjithmonë në gjendje të marrë dhe ta konstatojë më nga afër të gjithë procesin, nuk mban vetëm shënime.

Do ta detajojmë më tej në ligj, zoti kryetar, sepse, në fakt, është nen kushtetues. Nëse doni që ta kalojmë të gjithin në ligj dhe ta bëjmë pastaj me nene pafund jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Majko, Gjykata Kushtetuese, së pari është një organ jashtë aspektit korporativ.

Së dyti, ne nëpërmjet kalimit të Gjykata Kushtetuese dhe jo tek ajo që ishte parashikuar më parë, mendojmë se ia kalojmë një trupe, e cila ka një përgjegjshmëri publike në kohë që është gjykatë. Ia kalojmë asaj dhe Gjykata Kushtetuese është një organ, i cili më pas mban përgjegjësi jo vetëm kushtetuese, por edhe përballë publikut.

Tani, për ta detajuar më tej, e kemi kollaj ta bëjmë diku tjetër, por ne mendojmë që veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese për sa i përket shqyrtimit të ankimeve, nëse do të ketë, sepse ndoshta e bëjnë aq mirë detyrën organet e tjera (në versionin tuaj ato komisione mund të mos kenë fare punë, pra mund të mos kenë ankim) sa të gjithë të binden se shqyrtimi i rastit dhe masa disiplinore është 100% e drejtë dhe gjyqtari apo prokurori i gjykuar e pranon faktin dhe ikën. Nëse do të ketë, do të shkohet në organin ankimor.

Ne mendojmë se Gjykata Kushtetuese është organi më i përshtatshëm për këtë, por përgjatë kësaj periudhe për këtë funksion mendojmë se duhet monitoruar nga Komisioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

Unë besoj se ne mund ta detajojmë më tej, por besoj se këtu biem dakord se duhet ta monitorojmë këtë pjesë.

Fatmir Xhafaj - Që ta qartësojmë pak se çfarë është monitorimi në ligj do të na duhet të mësojmë konceptin se çfarë është monitorimi mbi Gjykatën Kushtetute pasi të jetë botuar vendimi në Fletoren Zyrtare, siç thatë ju. Unë për këtë pyeta, nuk është se kam ndonjë gjë.

Së dyti, kam një merak, që duhet të ma sqarosh. Duke shkuar në Gjykatën Kushtetuese a kanë të drejtë ankimi këta diku pas kësaj, se i bie të kemi vetëm një shkallë gjykimi?

Oerd Bylykbashi - Nëse ju mendoni se duhet të kemi një shkallë gjykimi mbi Gjykatën Kushtetuese, mund të fillojmë të ngjitemi pak më lart se aq, por unë mendoj se nuk është rasti i parë që në praktikën ekzistuese të kemi një shkallë ankimi.

Fatmir Xhafaj - Ku? Kemi Gjykatën e Lartë për zyrtarët e lartë. Po ne atë po prishim, që të mos ketë një shkallë gjykimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po gjykim administrativ është i gjithë gjykimi për procesin zgjedhor.

Pandeli Majko - Një kundërshtim mund ta bëjmë ne?

Fatmir Xhafaj – Po, dakord, por nuk kundërshtohet opozita!

Pandeli Majko - Nuk po e quaj kundërshtim, por e quaj debat.

Sistemi juaj antikorporatist në çështjet e vlerësimit apo të trajtimit të shqetësimeve që do të kenë gjyqtarët në të gjithë procesin e trajtimit të tyre nga reforma e drejtësisë, të cilin e lidhin me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Duke lidhur vendimin e Gjykatës Kushtetuese me monitorimin ndërkombëtar, do të më falni, por është gjykata më supreme në Shqipëri, ndaj, pyetja më naive që shtrohet është: në qoftë se monitoruesit ose monitoruesi do të jenë kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese, çfarë ndodh me sistemin që na ofroni ju si propozim? Atëherë, do të pranojmë që kemi, çfarë? Do të kemi të drejtën që të revokohet vendimi i gjykatës më të lartë, që interpreton Kushtetutën, nga një monitorues ndërkombëtar? Rishikojeni pak, ju lutem! Edhe nga pikëpamja e të drejtës kushtetuese. Jam i bindur në aftësitë tuaja, pa diskutim.

Oerd Bylykbashi – Meqë nuk e keni mundësinë ta lexoni, e pashë që ishte më efektive po ta lexonit. Te pika 5, germa “c” e nenit 3, që flet për komisionet ndërkombëtare të monitorimit, ne themi: “Vëzhguesit ndërkombëtar i ushtrojnë këto detyra dhe kompetenca”. Germa “c” thotë: “Paraqesin gjetje dhe mendime për çështjet që shqyrtohen nga organet e rivlerësimit. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesit ndërkombëtarë mund të kërkojnë që organi i rivlerësimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit”. Kjo është siç e shikojmë ne. Të mos harrojmë

që vëzhguesit ndërkombëtar bëjnë të njëjtën gjë edhe me Kolegjin e Posaçëm të Gjykatës Kushtetuese, që ju e mendoni si një trup. E spostuat, nga Gjykata e Lartë menduat ta çonit pranë Gjykatës Kushtetuese për t'i dhënë nivelin e saj. Ne mendojmë se është më e thjeshtë në këtë formë, e para.

E dyta, e përcaktojmë se çfarë bën. Pra, i thotë organit përkatës: merr dhe shqyrto edhe këto elemente, sepse është në diskrecionin e tyre në fund fare, por ama, jemi duke limituar vetëm tek aspekti ankimor i procesit për të cilin po flasim.

Zoti Majko, nuk po flasim fare për pjesën që ka të bëjë me interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese. Në rastin konkret, i themi madje që nuk mund të shqyrtojë as bazën kushtetuese mbi të cilën bëhet procesi.

Fatmir Xhafaj – Kam edhe një merak të fundit, që ta mbyllim çështjen e Gjykatës Kushtetuese. Edhe në kapitujt e mëparshëm ju i keni dhënë, gjithashtu, një rol tjetër Gjykatës Kushtetuese, disa kompetenca të tjera, përfshirë edhe këto të vetingut, që janë 800 gjyqtarë. Sikur gjysma, apo $\frac{1}{4}$ e tyre të shkojnë për ankim, plus dispozitat, Gjykatën Kushtetuese me 9 veta, mos duhet ta bëjmë me 18?

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ju mendoni se procesi i vetingut, i monitoruar, do të ketë kaq shumë pasaktësi, që të shtohen kaq shumë? Kaq keq e mendoni ju këtë proces që do të bëhet?

Fatmir Xhafaj – Po ju mendoni se procesi i ankimit është ndërtuar për shkak të pasaktësive në Shkallën e Parë, apo për shkak të kontrollit të zbatimit të ligjit?

Oerd Bylykbashi – Ne po japim një proces që është ankim në një gjykatë. Ajo që ju propozoni nuk është gjykatë, e para.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Komisioni i Venecias kërkon që ta kesh të drejtën e ankimit në gjykatë.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk propozojmë gjë ne, e kanë propozuar ekspertët.

Oerd Bylykbashi – Por të jetë e nevojshme për këtë periudhë, atë që bëjnë sot, do ta shtojnë në nivelin e punës së tyre por, këta gjykatës që janë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Po nuk mund të jetë kjo çështja për të cilën ju mund të thoni se do të bëjmë një strukturë të veçantë vetëm për iks vjet, sa doni të bëni ju, vetë e vetëm që të bëhen dy struktura paralele dhe të vendosen njerëzit që doni ju.

Fatmir Xhafaj – E di çfarë kam merak? Gjykata Kushtetuese ka një lloj gjykimi të posaçëm, të veçantë, është gjykim kushtetues. Ne po i japim gjykatës cilësitë e një Gjykatë Administrative dhe të Shkallës së Parë. Kam përshtypjen se po i ngatërrojmë.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, e keni vënë re që, për shkak të situatës së posaçme që ne po biem dakord, po bëjmë diçka që në Kushtetutë nuk shkruhet kurrë? A keni parë ndonjë Kushtetutë që të ketë këtë gjë që po themi ne se duhet shkruar? Për sa kohë jemi në kushtet...

Fatmir Xhafaj – Po pse keni parë ju kaq gjyqtarë të korruptuar?

Oerd Bylykbashi – Jo, jo është një histori, të cilën e pranojmë kështu, por është perceptision. Kur ta masësh rast pas rasti, atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Një sekondë, ju lutem!

Perceptioni, zoti Majko, mund t jetë më i fortë se realiteti, jam dakord me ju, por do ta shikojmë rast pas rasti nëse gjyqtari iks apo ipsilon duhet të ikë, apo duhet të qëndrojë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Por kjo duhet bërë me garanci, jo me organe që krijohen me shumica të cilësuar në parlament, sipas shumicës që keni ju.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

U sqaruam, se ne kishim nevojë të ndriçoheshim. U ndriçuam.

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te neni “Shqyrtimi në apel”, unë mendoj se ka nevojë të bëjmë disa ndryshime redaktoriale. Janë ndryshime të vogla, por krijojnë një lidhje logjike midis vlerësimit në Shkallë të Parë, shqyrtimit në Apel dhe masave disiplinore. Për shembull, unë jo pa qëllim pyeta që te neni F, që diskutuam pak më parë, ne kemi përmendur masa disiplinore që jepen, si nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve, edhe nga Kolegji. Pra, ne kemi folur për masa disiplinore që jep Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit, pa folur ende për shqyrtimin në Apel dhe do të ishte më logjike që të flisnim për shqyrtimin në Shkallë të Parë, për shqyrtimin në Apel dhe më pas për masat disiplinore. Pse e them këtë? Sepse ne u kthehemi dy herë masave disiplinore edhe te neni F, edhe te neni G. Nga ana redaktoriale, nëse do t’i lëmë formulimet siç janë, dy

fjali që janë te neni G, i bie të kalojnë te neni F. Për shembull, fjalia që “Gjyqtarët e emëruar në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit mund të gjykojnë ankimet kundër vlerësimit të kualifikimit sipas këtij aneksi”, do të shkonte shumë mirë kur flasim te masa disiplinore, sepse, më pas ne themi: “Subjekti i rivlerësuar gëzon të drejtën e ankimit pranë Kolegjit”, ankimon masat, por ne masat i kemi thënë më lartë. Pra, pa u ndryshuar përmbajtjen fjalive, vetëm të ndryshonim vendet, do të doja të flisnim se cili është shqyrtimi në Shkallën e Parë, shqyrtimi në Apel, cili është produkti që japin në këto dy shqyrtime, janë masat disiplinore dhe më pas të fillojmë t’i trajtojmë masat disiplinore siç janë te pika 2 e nenit F dhe me radhë te pika 3 e nenit G.

Unë kam një pyetje për ekspertët. Përveç anës redaktoriale dhe të teknikës legjislative, përdoret një fjali e formuluar kështu: “Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit siguron respektimin e të drejtave themelore të subjektit të vlerësuar brenda kufijve të përcaktuar nga neni A i këtij ligji. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në ligj”. Shqip, nuk del qartë. Ndoshta është problem përkthimi. A mund të sqarohet se çfarë kanë dashur të thonë ekspertët, sepse kjo është një fjali e shtuar nga ata?

Gjithashtu, ju keni përmendur në pikën 6, që subjekti i vlerësuar gëzon të drejtën t’i drejtohet Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo është absolutisht e drejtë, por në Kushtetutë nënkuptohet e drejta për ankimim, pasi ke konsumuar mjetet e brendshme ligjore. Besoj se keni bërë një zgjidhje garancie politike për të qetësuar ose për të kënaqur Komisionin e Venecias.

Fatmir Xhafaj – Është garanci kushtetuese.

Vasilika Hysi – Unë këtë kam merak dhe në këtë kuadër, në rast se do të bëjmë risistemim të paragrafëve, edhe paragrafi 4 është përsëritje: “Subjekti i vlerësuar, kur ushtron ankimin kundër masës disiplinore, pezullohet nga detyra”. Pra, ka nevojë që të themi: rregullat procedurale në Shkallën e Parë, në Apel, masat disiplinore dhe çfarë ndodh me pasojat kur është dhënë një vendim shkarkimi dhe kur është dhënë një vendim vazhdimi të formimit profesional, çfarë ndodh me pagën e kështu me radhë? Kjo do të ishte shumë e qartë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllim këtu.

Zoti Deville ka një koment. Urdhëroni!

Rainer Deville – Referenca në paragrafin 1 bëhet për shkak të Komisionit të Venecias dhe Komisioni i Venecias sugjeroi që gjasat duhet të jenë në anën e sigurt ose përsëri duhet drejtuar vëmendja ndaj të drejtave themelore dhe mundësisht mund ta bëni më të qartë duke cituar po ashtu Nenin 179/b, ku kemi edhe parimet themelore. Pastaj Neni A që i referohet Kushtetutës, por sigurisht të drejtat kushtetuese kufizohen në Nenin A. Kështu që ndoshta do t'ju duhet të gjeni një referencë tjetër këtu. Kjo është pak sipas stilit barok, por në fakt qëllimi ishte që ta bënim sa më të lehtë që mundeshim për të qenë sigurisht në krahun e Strasburgut, që të ishim të qartë dhe u sugjerua që të ishim tamam në krahun e sigurtë. Nëse mendoni se paragrafi 6 është një farë promovimi për sigurimin e Këshillit të Evropës nga ana e organit të Këshillit të Evropës, ku ky është edhe vlerësimi juaj, është sugjeruar që kjo duhet verifikuar për ta bërë të qartë që kjo e drejtë nuk është e kufizuar, në menyrë që të mos shkelë asnjë nga detyrimet ndërkombëtare. Faktikisht është e qartë, kështu që nuk ka gjë që është aty.

Fatmir Xhafaj - Dakord, vazhdojmë me nenin H, “Dorëheqja”.

Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – E thashë, zoti kryetar, ne e kemi të përfshirë në dispozitën tjetër, kështu që nuk kemi propozim për këtë, nuk e kemi nen të veçantë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ke merak kur kanë pak vjet, apo jo?

Vasilika Hysi – Po, kam një merak te paragrafi i dytë i “Dorëheqjes”. Ju thoni se, nëse subjekti i dytë jep dorëheqjen, ai përfiton menjëherë nga e drejta e pensionit, sipas ligjit. Po në rast se ai ka vetëm 2 vjet punë? Kjo bie ndesh me ligjin që ne kemi, që një person, për të marrë një pension, duhet të ketë një minimum vitesh.

Fatmir Xhafaj – Sipas ligjit, nuk do të marrë.

Vasilika Hysi – Sipas ligjit, ai nuk merr pension, prandaj, duke i njohur të drejtën për pension, ai me të drejtë mund të vijë dhe të thotë: dua pension, ndërkohë që ne kemi një minimum vitesh. Sipas ligjit, duhet të kesh 20 vjet pune që të marrësh pension. Më falni, në qoftë se e kam të saktë 20 vjet, sepse kemi bërë edhe reformën e pensioneve, prandaj duhet pasur pak kujdes.

Fatmir Xhafaj – Unë mendoj se, përderisa është thënë “sipas ligjit”, është e qartë, se sa i takon, të marrë, në atë masë që i takon sipas ligjit në fuqi. Ky ligj nuk ka bërë rregullim të

posaçëm që të thuash se ka përjashtim në rastin e vlerësimit, por nëse i takon gjysmë, do të marrë gjysmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord. Mos është kontekst tjetër dhe ndoshta nuk e kuptoj unë?

Rainer Deville – Ajo që duam të bëjmë është të hapim një derë për ata që dëshirojnë të largohen dhe çështja që shtrohet është se kur del në pah kjo dorëheqje. Kështu që, mundësisht, në ligjin zbatues na duhet të japim një përgjigje që duhet të jetë e dukshme sipas një periudhe kohore, ndoshta në shkallën e parë, me qëllim që kjo të kthehet në një mekanizëm zyrtar pastrimi dhe pastaj edhe pensioni duhet rregulluar në ligjin zbatues. Ne i hodhëm një sy skemës, pra ajo nuk është automatike. Mendoj që ekziston një ligj kur gjyqtarët japin dorëheqjen e ata kanë një pension kalimtar e pastaj kanë pensionin e rregullt që marrin vetëm pas moshës 65 vjeçare. Këtë gjë duhet ta rregullojmë në ligj për të parë se cili është edhe skenari i përshtatshëm në nivelin zbatues. Ky jep vetëm parimet, pra që ata duhet të largohen dhe të mos largohen pa gjë. Pra duhet të ketë një lloj skenari që duhet rregulluar. Ç'do të ndodhë nëse këta njerëz largohen? Por kjo gjë zbatohet në legjislacion e ne thjeshtë i referohemi atij.

Dakord.

Urdhëroni, zoti Smibert!

Jon Simbert – Kjo është mjaft e qartë në nenin H, ku dorëheqja mund të jetë mjaft e rëndësishme. Në Kosovë, kur e bënë procedurën e verifikimit, më shumë se 10% e njerëzve nuk riaplikuan. Ata patën një sistem të ndryshëm. Kjo mund të jetë diçka mjaft e ngjashme. Kjo mund të jetë më efektive, që do të thotë që nëse njerëzit nuk përballen dot me shqyrtimin kritik të publikut, edhe kjo është e njëjta gjë, që faktikisht mund të çojë në një nivel të lartë pastrimi të sistemit.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Kam një merak të fundit për pikën 3 të këtij neni, që subjekti i vlerësuar, i cili jep dorëheqjen sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar në asnjë shkallë e të tjera për një periudhë 10-vjeçare. Kuptimi juaj është që pas 10 vjetësh mund të rikthehet, megjithëse është dorëhequr për t'i shpëtuar këtij procesi vlerësimi?

Rainer Deville – Në teori, sigurisht kjo gjë është e mundur, por shpresojmë që pas 10 vjetësh të ketë një vlerësim adekuat që do të tregojë se cilët njerëz po aplikojnë dhe pastaj mbetet vendimi juaj ose vendimi i organit kompetent për të vlerësuar nëse këta njerëz kanë ndërruar

sjelljen e tyre apo jo. Ndoshta, shumica e atyre që japin dorëheqjen mund të jenë në fund të përvojës së tyre të punës dhe të tjerë mund të punojnë për 10 vjet si avokatë të suksesshëm. Por, në fakt kjo është e mundur. Parimi i këtij komisioni është që asgjë nuk zgjat përgjithmonë. Ne patëm një diskutim të tillë për Nenin 6/1, pra duhet të jeni të qëndrueshëm. Ka një afat kohor për njerëzit që të kenë edhe një mundësi të dytë, por pastaj keni vënë në vend një sistem adekuat verifikimi e përzgjedhjeje të cilin mund ta aplikoni.

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E mbyllëm këtë.

Vasilika Hysi – Kisha ndër mend ta lija, por më provokuat ju me pyetjet që bëtë.

Ju thoni që për 10 vjet personi mund të ketë të drejtë, por, në rast se ai në të tre dosjet dhe vlerësimet është negativ, mendoni se pas 10 vjetësh do të jetë i pastër? Pra, ato para të pista që ka bërë, aftësimin e të tjera, i ka plotësuar?

E dyta, ne themi se nuk duhet të jenë gjyqtarë, prokurorë, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe inspektorë. Po në administratë publike dhe në pozicione të tjera mund të punojnë? Sepse ne i kemi kufizuar vetëm në një grup pozicionesh, por ka pozicione të tjera që janë shumë të ndjeshme, sikurse janë edhe në institucionet që ju i keni përmendur në mënyrë taksative në Kushtetutë. Për mendimin tim, ata nuk kanë më as integritet moral, as profesional, që të shërbejnë në detyra të tjera.

Rainer Deville – Kjo është pyetja së cilës duhet t'i përgjigjeni nëse njerëzit aplikojnë për pozicione të tjera. Kështu që ne nuk kemi vendosur lidhur me këta skenarë të tjerë të mundshëm. Nëse këta persona aplikojnë diku në shërbimin publik, ju keni një sistem të përshtatshëm vlerësimi dhe nëse njerëzit pas 10 vjetësh janë më të mirë ose jo, këtë gjë duhet ta vendosni pas 10 vjetësh. Është e rrallë që të mund ta prisni një gjë të tillë, por ju nuk mund në parim ta përjashtoni atë në mënyrë të menjëhershme.

Jon Simbert – Dëshiroj të shtoj vetëm diçka. Mos harroni që kjo ka të bëjë me hapjen e një dore që i mundëson njerëzve largimin. Ata nuk largohen me provën e të pasurit të dosjes, ndoshta ju nuk e keni krijuar akoma dosjen, kështu që nëse doni ta bëni 20 vjet apo “ndonjë pozitë tjetër publike”, mund ta bëni një gjë të tillë, por pastaj duhet të kufizoni efektin e pastrimit, sepse njerëzit do të thonë që nuk kam asnjë mundësi tjetër e duhet ta bëj këtë gjë, e në

një farë mënyre më duhet të fsheh Ferrarin e gjithë gjërat e tjera. Kjo ka të bëjë me shumë me funksionimin e këtij neni sesa me pastrimin e të gjitha vendeve ku ata mund të shkojnë.

Fatmir Xhafaj – Me debatin për këtë nen mbyllet edhe kapitulli “Aneksi për vlerësimin kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Tashmë e kemi kaluar të gjithë projektin nen për nen në një debat të gjatë dhe konkret. Mbetet që ekspertët bashkë me ndihmën e sekretariatit teknik të bëjnë zbardhjen dhe vlerësimet se cili është qëndrimi final që kanë, dhe më pas ngelet në diskutimet e mëtejshme për të zgjidhur çështjet, siç është çështja e shumicave të cilësuar, që na takon neve t’i zgjidhim, besoj shumë shpejt. E rëndësishme është që me këtë e mbyllim sot, e kemi të qartë se çfarë janë dhe çfarë nuk janë dhe, siç është rënë dakord, mbetet që ju të bëni një përmbledhje, një vlerësim dhe një reformulim atje ku e çmoni të nevojshme, bazuar në ato çfarë kanë thënë kolegët deputetë në komision.

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, në përfundim të këtij procesi, pavarësisht se ishte i gjatë, ishte vërtet e domosdoshme që të shpalosnim qëndrimet dhe zgjidhjet tona. Ashtu siç biem dakord që janë aspekte që duhen draftuar më mirë, që janë të qarta, po ashtu ka nevojë që pjesë të këtij drafti të mos jenë pjesë në draftin kushtetues, por eventualisht të jenë pjesë e ligjeve që do të bëjnë zbatimin e kësaj pjese. Thelbësore është që ne duhet të zgjidhim çështjet që janë me karakter politik. Ju theksuat vetëm një aspekt, ndërkohë që, për të qenë të plotë, edhe për atë që thotë Komisioni i Venecias, është çështja e vendimmarrjes politike, por, në fakt, themelore është çështja e arkitekturës së sistemit, e cila, e zgjidhur, sigurisht që lehtëson çështjen e shumicës vendimmarrëse, që, në vetvete, kërkon një zgjidhje. Por sa më e rëndë të jetë arkitektura, me sa më shumë institucione që kërkojnë këtë vendimmarrje, aq më problematikë është problemi i vendimmarrjes dhe, për rrjedhojë, aq më akut bëhet politikisht.

Gjithsesi, e parë në kompleks, ne propozojmë një zgjidhje më të thjeshtë, ju keni këtë zgjidhjen tjetër. Do të vazhdojmë dhe besoj se do të gjejmë zgjidhjet e përbashkëta dhe do të marrim votën e parlamentit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Besoj se u mirëkuptuam. Jam shumë dakord për një pjesë të diskutimit të zotit Bylykbashi, atë që ka të bëjë me faktin që gjatë rishikimit të sugjerimeve dhe propozimeve që u bënë, në materialin përfundimtar të saktësohet në një memo bashkëlidhur se cilat janë pjesët që

hiqen dhe do të kalojnë te ligji, se çfarë kanë kërkuar deputetët gjatë debatit, që të mbahen në konsideratë në ligjin kuadër për fushën përkatëse. Këtu jam shumë dakord, që kjo duhet ta shoqërojë projektin.

Gjithashtu, nuk jam fare dakord për sa i përket çështjes së arkitekturës së sistemit. Mendoj se është një çështje e mbyllur nga Komisioni i Venecias dhe nuk është një çështje që mbetet te debati politik. Por këtu ndahemi, këtu mund të bashkohemi ose mund të ndahemi përfundimisht, por unë besoj se mund të bashkohemi duke e zgjidhur çështjen me shumicë të cilësuar, që, pa dyshim, e kam pranuar që në fillim të këtij debati, është një çështje që kërkon konsensus nga palët, të cilët në përfundim të këtij dialogu, që ishte politik, sepse, në fund të fundit, kjo është një tryezë politike, dialogojnë mbi draftin konkret në opinionin e Komisionit të Venecias, këndvështrimin ose reflektimin në mënyrën se si e kishin lexuar ekspertët ndërkombëtarë, por, gjithsesi, mbetet e hapur për proceset e mëtejshme, siç e thashë.

Gjithsesi, besoj se më duhet ta mbyll këtu.

Oerd Bylykbashi – Panevojshmëria e theksimit, zoti kryetar, që është vetëm kjo çështje dhe çfarë ka zgjedhur Komisioni i Venecias, ta themi: ju mendoni se është vetëm kjo çështje politike, sipas Komisionit të Venecias, ne themi: është e thënë e zezë mbi të bardhë nga Komisioni i Venecias që është e vendos legjislatori shqiptar. 94 vota i duhen këtij sistemi.

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Unë besoj se kemi detyrimin, edhe në emrin tuaj, t'u bëjmë një falënderim të veçantë dy zotërinjve të nderuar, shefit të misionit të EURALIUS-it, zotit Rainer Deville dhe përfaqësuesit të OBDAT-it, zotit Jon Smibert!

Gjithashtu, falënderojmë ekipin e tyre për punën e mrekullueshme që kanë bërë, për angazhimin që kanë treguar, për durimin që kanë pasur gjatë gjithë këtij procesi, por në mënyrë të veçantë gjatë gjithë dialogut politik në komision dhe, natyrisht, edhe stafit tonë të sekretariatit teknik për angazhimin dhe për përcjelljen që i kanë bërë këtij debati, por më shumë për atë që do të bëjnë në vazhdim, sepse puna e vërtetë për ata fillon tani!

Gjithashtu, dua të bëj një falënderim edhe për ekipin e përkthyesve dhe stafin tjetër teknik që e kanë mbështetur këtë proces!

Faleminderit!

Natën e mirë!

Oerd, edhe 100 vjeç!

Dhurata për Oerdin ishte kapitulli i vlerësimit.

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë